



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr.1116/61Prot.

Tiranë, më 31/12/2016

V E N D I M

Nr. 191 Datë 31/12/2016

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TEMATIK TË USHTRUAR NË
19 SUBJEKTE “MBI VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË MASAVE TË
REKOMANDUARA NË AUDITIMET E MËPARSHME”.**

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, gjatë auditimeve të evaduara gjatë vitit 2015 dhe 2016, sipas programit të auditimit nr. 1116, datë 04.11.2016 si dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit nr. 1, datë 04.11.2016 “*Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, rezultoi se në **19** subjekte të audituar ka rezultuar si më poshtë:

- Janë rekomanduar gjithsej **981** masa, nga të cilat janë pranuar **911** masa, ose 92.9 % e masave të rekomanduara dhe nuk janë pranuar **70** masa, ose 7.1 %.

a- Niveli i zbatimit të rekomandimeve rezulton: zbatuar plotësisht **552** masa, ose 56.4 %, pjesërisht **21** masa ose 2.1%, në proces zbatimi **223** masa, ose 22.7 % dhe **185** masa të të pazbatuara, ose 18.8%.

b- Niveli i realizimit të masave, sipas llojit paraqitet si më poshtë:

- **Masa organizative**, nga **691** të rekomanduara, janë pranuar **689**, pra 99.7%, janë zbatuar plotësisht **460** masa, ose 66.8%, pjesërisht 12 masa ose 1.7%, në proces zbatimi **173** masa, ose 25.1 % dhe **46** masa të pranuar dhe të pazbatuara, ose 6.4%.
- **Masa shpërblim dëmi**, nga **95** masa të rekomanduara, janë pranuar **92**, ose 96.8%, janë zbatuar plotësisht 7 masa, ose 7.4%, pjesërisht 9 masa ose 9.5%, në proces zbatimi 50 masa, ose 52.6 % dhe 29 masa të pranuar dhe që nuk ka filluar zbatimi, ose 30.5%. **Zbatimi në vlerë** është si vijon: **95** masa të rekomanduara **me vlerë 584,021 mijë lekë**, janë pranuar **92**, në vlerë **419,327 mijë lekë** ose 71.8%, janë zbatuar plotësisht **7** masa me vlerën **17,186 mijë lekë** ose 2.9%, janë zbatuar pjesërisht **9** masa me vlerën **8,995 mijë lekë**, ose 1.5%, në proces zbatimi **50** masa në vlerën **173,801 mijë lekë**, ose 29.8% dhe janë pazbatuar (paarkëtuara) 29 masa me vlerë 384,039 mijë lekë, ose 65.7%.
- **Masa disiplinore**, nga **195** masa të rekomanduara, janë pranuar 130 masa, ose 66.7%, nga të cilat janë zbatuar 85 masa ose 44%. Për 65 masa nuk ka informacion nga institucionet e prokurorisë (ZQRPP dhe D.P. ALUIZNI Tiranë) dhe nuk janë zbatuar 45 masa disiplinore të rekomanduara dhe të pranuar. Gjithsej janë 110 masa të pazbatuara ose 56 %.

Bazuar në korrespondencën me subjektet brenda afatit 20 ditor, lidhur me planin e masave për rekomandimet e lëna gjatë kontrollit, rezulton se nga masat organizative dhe për shpërbllim dëmi të rekomanduara, nuk janë pranuar 5 rekomandime ose 0.7 % (2 masa organizative dhe 3 masa shpërbllim dëmi), ku përmendim subjektet:

1. ALUIZNI Durrës, nuk ka pranuar 2 rekomandime (masa shpërbllim dëmi).
2. ALUIZNI Gjirokastër, nuk ka pranuar 1 rekomandim (masë shpërbllim dëmi).
3. ZVRPP Kukës, nuk ka pranuar 1 rekomandim (masë organizative).
4. ZVRPP Devoll, nuk ka pranuar 1 rekomandim (masë organizative).

Në zbatim të kërkesave të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjektet kanë kthyer përgjigje brenda 20 ditëve në KLSH, mbi masat e mara për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportet përfundimtare të auditimit nga KLSH, sipas afateve të përcaktuara. Konstatohen subjekte që nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Bazuar në këto rezultate të lidhura me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm”, të ushtruar në **19** subjektet të audituara në periudhën 01.10.2015 – 30.09.2016.

II. TË RIKËRKOJ marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve për të gjithë subjektet e audituara, si më poshtë:

1. ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ZVRPP) FIER.

Nga auditimi i ushtruar në ZVRPP Fier, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë e vlerësues i aktivitetit të institucionit” për periudhën 01.01.2013 deri 30.05.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 127, datë 24.09.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 503/11, dt. 24.09.2015, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ZVRPP Fier ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve, me shkresën përcjellëse nr. 7220/1, datë 16.10.2015, me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ZVRPP Fier **nuk** ka kthyer përgjigje në KLSH,

brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve të KLSH, por në vazhdimësi ka njoftuar KLSH-në për veprimet e kryera për pasuritë e kufizuara.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë **91** rekomandime gjithsej, nga këto: 78 masa organizative, 2 masa zhdëmtimi me vlerën 152,354 lekë dhe 11 masa disiplinore (nga të cilat 11 masa “vërejtje me paralajmërim” dhe 2 masa për “Zgjidhje të kontratës së punës).

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 78 masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 78, janë zbatuar 76 dhe janë në proces zbatimi 2 rekomandime.

b. Për shpërblim dëmi janë lënë 2 rekomandime për shumën 152,354 lekë, nga të cilat, janë pranuar 2 rekomandime në vlerën 152,354 lekë, nga këto është zbatuar 1 rekomandim duke arkëtuar detyrimin financiar në shumën 80,000 lekë dhe është në proces zbatimi rekomandimi për vlerën 72,354 lekë.

c. Mbështetur në nenet 37,141, 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe nr. 9125, datë 29.07.2003, janë rekomanduar: 2 masa disiplinore “Zgjidhje të kontratës së punës” nga të cilat 2 masa janë pranuar dhe zbatuar, 2 , gjithashtu janë rekomanduar 9 masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim”, nga të cilat 9 masa janë pranuar dhe janë zbatuar 9 masa disiplinore.

Në përfundim **rikërkojmë** nga ZVRPP Fier, përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 908/8, datë 29.12.2015, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara.

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 5.

Regjistruesi i ZVRPP Fier të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për personat përgjegjës, që nuk kanë ndjekur procedurat gjyqësore.

Brenda 3 mujorit të parë 2017

Rekomandimi 32.

Regjistruesi i ZVRPP Fier të marrë masa, të vendosë datë përfundimtare në kartelat e pasurisë së paluajtshme volumin 31 ZK 8531, ZK 1341, si dhe të plotësoj kartelat e pasurisë së paluajtshme, volum 10, faqe 63, 64, 65, 66, 67, 75, ZK 3922.

Brenda 3 mujorit të parë 2017

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandimi 1.

Regjistruesi i ZVRPP Fier të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimin e shumës 72,354 lekë për K. Z.

Brenda 3 mujorit të parë 2017

2. NË AGJENCINË E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE NDËRTIMEVE INFORMALE (ALUIZNI) DURRËS

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria e ALUIZNI-t Durrës ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve, me shkresën përcjellëse nr. 213322/1, datë 15.01.2016, me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve, me shkresën përcjellëse nr. 3160, dt. 8.04.2016, dhe 8358/1, dt. 20.06.2016 dhe tonën 908/15 dt. 6.07.2016 me njoftim për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë **29** rekomandime gjithsej, nga këto: **12** masa organizative dhe **6** masë zhdëmtimi me vlerën **164,443,016** lekë, si dhe **11** masa disiplinore (Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës nga “Vërejtje me paralajmërim” deri “Largim nga detyra”).

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **12** masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht **12**, nga të cilat janë zbatuar 7 dhe janë ezuaruar 5 rekomandime, 3 nga të cilat janë ezuaruar për shkak të ndryshimeve ligjore, ndërsa 2 janë detyra të Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t.
- b. Për shpërblim dëmi janë lënë **6** rekomandime për shumën 164,443,016 lekë, nga të cilat, nuk janë pranuar 2 rekomandime në shumën **161,109,722** lekë (që përbëjnë 3968 raste me vlerë 159,713,778 lekë si taksë e ndikimit në infrastrukturë e paarkëtuar në NJQV-të përkatëse dhe 2,749,278 lekë penalitete të shtesave vertikale dhe horizontale në objektet me leje ndërtimi), janë pranuar 4 masa shpërblim dëmi në vlerën 3,333,294 lekë. Janë zbatuar 3 rekomandime në vlerën 46,568 lekë, është zbatuar pjesërisht 1 masë shpërblim dëmi në vlerën duke arkëtuar detyrimin financiar në vlerën 538,038 lekë, mbetet në proces arkëtimi i vlerës prej 2,749,278 lekë.
- c. Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës janë rekomanduar: **11** masa disiplinore nga “Vërejtje me paralajmërim” deri “Largim nga detyra” nga të cilat **11** janë pranuar, lidhur me nivelin e zbatimit të tyre nuk ka informacion në Drejtorinë e ALUIZNI-t, Durrës.

Eprori direkt, në këtë rast nuk është Drejtoria e ALUIZNI-t, Durrës, e cila ka kompetencën për dhënien e masave disiplinore.

Në përfundim **rikërkojmë** nga Drejtoria e ALUIZNI-t, Durrës përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 908/8, datë 29.12.015, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara.

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

4.1. Rekomandimi:

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Durrës, të marrë masa duke ndjekur rrugët ligjore për llogaritjen, saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së tarifës së parcelës ndërtimore prej 1,395,944 lekë, konkretisht ndaj personave;

-E.S., E.O.S., G. & J. S. S., për vlerën 953,464 lekë;

- P. E. Z., për vlerën 249,285 lekë;
- E. M. Th., për vlerën 172,395 lekë;
- M.O. dhe E. F. O., për vlerën 20,800 lekë.

Brenda 3 mujorit të parë 2017

Rekomandimi 5.

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Durrës, të marrë masa duke ndjekur rrugët ligjore për llogaritjen, saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së penalitetit të shtesave vertikale dhe horizontale në objektet me leje ndërtimi me vlerë **2,749,278 lekë**, konkretisht ndaj personave:

- F. N. E., për vlerën 81,809 lekë;
- Y. S. K., për vlerën 81,809 lekë;
- I. J. Ç., për vlerën 505,400 lekë;
- “T”, për vlerën 1,485,960 lekë;
- F. V., për vlerën 594,300 lekë.

Brenda 3 mujorit të parë 2017

Rekomandimi 6.1.

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Durrës në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore të Qarkut Durrës, të marrin masa duke ndjekur rrugët ligjore për llogaritjen, saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së taksës së infrastrukturës, ndaj 3968 personave me vlerë 159,713,778 lekë.

Brenda 3 mujorit të parë 2017

3. NË AGJENCINË E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE NDËRTIMEVE INFORMALE (ALUIZNI) GJIROKASTËR

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e ALUIZNI-t Gjirokastrë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë e vlerësues i aktivitetit të institucionit” për periudhën 01.09.2013 deri 01.10.2015, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 155, datë 03.12.2015 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 765/13, datë 03.12.2015, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria e ALUIZNI-t Gjirokastrë ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve, me shkresën përcjellëse nr. 2034/1, datë 22.12.2015, me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtorinë e ALUIZNI-t Gjirokastrë nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga data e marrjes së shkresës.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë **35** rekomandime gjithsej, nga këto: **20** masa organizative dhe **7** masa zhdëmtimi me vlerën 11,322,667 lekë, si dhe **8** masa disiplinore (Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës nga “Vërejtje me paralajmërim” deri “Largim nga detyra”).

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **20** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht **20**, nga të cilat janë zbatuar 17, është ezuaruar nga ndryshimet ligjore 1

rekomandim dhe janë në proces zbatimi 2 rekomandime. Nuk është pranuar 1 rekomandim, i cili konsiderohet i ezauruar për shkak të ndryshimeve ligjore.

- b. Për shpërblim dëmi janë lënë 7 rekomandime për shumën 11,322,667 lekë, nga të cilat, nuk është pranuar 1 rekomandim në shumën 3,584,364 lekë, janë pranuar 6 masa shpërblim dëmi në vlerën 7,738,303 lekë janë zbatuar pjesërisht 6 masa, duke arkëtuar detyrimin financiar në vlerën 218,627 lekë, mbetet në proces arkëtimi i vlerës prej 7,519,676 lekë.
- c. Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës janë rekomanduar: 8 masa disiplinore nga “Vërejtje me paralajmërim” deri “Largim nga detyra” nga të cilat 8 janë pranuar, lidhur me zbatimin e tyre nuk ka informacion në Drejtorinë e ALUIZNI-t, Gjirokastër, pasi kopetencën për dhënien e masave disiplinore e ka Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t.

Në përfundim rikërkojmë nga Drejtoria e ALUIZNI-t Gjirokastër, përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 765/13, datë 03.12.015 të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara.

A. MASA ORGANIZATIVE.

Rekomandimi 3.

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë të marrë masa, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat në pronat e Kryegjyshitës Botërore Bektashiane, të fillojë procedurat për rishikimin dhe shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të ligjit të legalizimit, ndërsa për personat të cilat janë në proces të legalizimit të bashkëpunohet me institucionet përkatëse, për marrjen e informacionit ligjor për vijimin e procedurave të legalizimit.

Brenda 3 muhorit të parë 2017

Rekomandimi 5.

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat, të fillojë procedurat, për rishikimin dhe shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe akteve ligjore të dala në zbatim të tij, si dhe në të ardhmen të mos legalizohen objektet të cilat nuk plotësojnë dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore të ligjit të legalizimit.

Brenda 3 muhorit të parë 2017

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, si më poshtë:

Rekomandimi 1.

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastër, të marrë masa në arkëtimin e vlerës **10,606 lekë**, ndaj ish-punonjësve dhe punonjësve; *D. M. në vlerën 5,303 lekë, F. Sh. në vlerën 5,303 lekë* dhe në të ardhmen faturat tatimore të likuidohen brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Brenda 3 muhorit të parë 2017

Rekomandimi 2.

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastër të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat

e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në shumën **4,711 lekë** nga personat përgjegjës; z. *F.M.* në vlerën 1,551 lekë, z. *D. M.* në vlerën 1,580 lekë dhe znj. *F. Sh* në vlerën 1,580 lekë.

Brenda 3 mujorit të parë 2017

Rekomandimi 3.

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në shumën **22,612 lekë**, si diferencë e ofertës fituese me ofertën më të ulët, nga personat përgjegjës; z. *D. M.* në vlerën 7,537 lekë, znj. *F. Sh.* në vlerën 7,537 lekë dhe z. *F. M.* në vlerën 7,537 lekë.

Brenda 3 mujorit të parë 2017

Rekomandimi 4.

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë të marrë masa, që nëpërmjet sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të kryejë kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit të kamatëvonesave në vlerën 312,112 lekë, ndaj ish-punonjësve; z. *D. M.* me detyrë ish-Drejtor për vlerën 156,056 lekë dhe znj. *F. Sh.* me detyrë ish-Përgj/Finance për vlerën 156,056 lekë, të cilët me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë sjellë si pasojë shkeljen e disiplinës financiare, duke tejkaluar pa ligjshmëri shpenzimet buxhetore me pagesat e kryera për gjërat dhe kamatë-vonesat, si shkaktarë të dëmit të konstatuar.

Brenda 3 mujorit të parë 2017

Rekomandimi 5.

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë të marrë masa, për llogaritjen, saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së tarifës së parcelës ndërtimore në **8 praktika** me vlerë **7,147,917 lekë**.

Brenda 3 mujorit të parë 2017

Rekomandimi 7.

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë të marrë masa, për saktësimin dhe arkëtimin e vlerës të gjobës për deklarim me vonesë në vlerën **7,000 lekë** dhe tarifës së shërbimit në vlerën **14,000 lekë**.

Brenda 3 mujorit të parë 2017

4. NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ZVRPP) GJIROKASTËR

Nga auditimi i ushtruar në ZVRPP Gjirokastrë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë e vlerësues i aktivitetit të institucionit” për periudhën 01.01.2013 deri 31.12.2015, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 51, datë 13.05.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1102/1, dt. 13.05.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ZVRPP Gjirokastrë ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve, me shkresën përcjellëse nr. 62, datë 28.07.2016, me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ZVRPP Gjirokastrë ka kthyer përgjigje në

KLSH, brenda 6 muajve, me shkresën përcjellëse nr. 1641/1, dt. 10.11.2016, me njoftim për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH. Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 86 rekomandime gjithsej, nga këto: 1 rekomandim për përmirësim ligjor, 67 masa organizative, 13 masa zhdëmtimi me vlerën 20,680,521 lekë, si dhe 6 masa disiplinore (nga “vërejtje” deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”).

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **67** masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht **67**, janë zbatuar **48**, janë në proces zbatimi **13** rekomandime dhe nuk janë zbatuar **6** rekomandime.
- b. Për shpërblim dëmi janë lënë **13** rekomandime për shumën 20,680,521 lekë, nga të cilat, janë pranuar 13 rekomandime, nga këto janë në proces zbatimi 13 rekomandime në vlerën 20,680,521 lekë, pasi janë bërë njoftimet përkatëse, si dhe janë vendosur kufizimet mbi pasuritë, por në vijimësi do të ndiqen rrugët ligjore për arkëtimin e kësaj shume. Nga kjo vlerë totale e konstatuar si dëm e ekonomik, në rekomandimin nr. 2, seksioni B “Masa Shpërblim dëmi” për vlerën **16,048,170 lekë**, ZVRPP-së Gjirokastër i është rekomanduar marrja e masave kufizuese për pasuritë, si dhe njoftimi i Bashkisë Gjirokastër për masat e marra, ndërsa ndjekja e rrugës për shpërblim dëmi i është rekomanduar Bashkisë Gjirokastër.
- c. Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës janë rekomanduar: **6** masa disiplinore nga “Vërejtje me paralajmërim” deri “Largim nga detyra” nga të cilat **6** janë pranuar, lidhur me zbatimin e tyre nuk ka informacion në ZVRPP Gjirokastër, pasi kompetencën për dhënien e masave disiplinore e ka ZQRPP Tiranë.

Në përfundim rikërkojmë nga ZVRPP Gjirokastër, përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1102/1, dt. 13.05.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara.

A. MASA ORGANIZATIVE.

Rekomandimi 2.

ZQRPP dhe ZVRPP Gjirokastër të ndjekin hapat e duhur ligjor për instalimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të vendosin Sistemin e Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) si dhe të hartojnë, miratojnë e zbatojnë Rregulloren e brendshme të Funkcionimit të Administratës së ZVRPP Gjirokastër, si njësi e vetme në territorin vendor, bazuar në organikat dhe organigramën dërguar nga Kryeministri me urdhrat nr. 196, datë 4.8.2014 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Urdhrin nr. 33, datë 2.4.2013 të Kryeministrit”. Në Rregullore të përfshihen, përcaktohen, shkruhen, kushtet e pranimit, testimi fillestar të aftësive profesionale dhe trajnimit në vazhdim të punonjësve në ZVRPP, statusi i të punësuarve, përcaktimi i kryerjes së detyrave, ushtrimi i kompetencave dhe mbajtja e përgjegjësive për secilin specialist, Regjistruer, zv. Regjistruer juristëve dhe punonjës të tjerë, si dhe detyrimet lidhur me përgatitjen e evidencave informacionit në tërësi dhe administrimin e dokumentacionit; si dhe për të gjitha këto procese dhe të punësuar të përcaktohen e vendosen SMKB (Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm) masa këto të detyrueshme në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 4.

ZVRPP Gjirokastrë të kryejë veprimet e rregullta në KPP-të, të njoftojë mbajtësit, tërheqë e shpall të pavlefshme certifikatat e pronësisë lëshuar në formë të parregullt në bashkëpronësi të pa ligjshme pasqyruar sipas veprimeve e shënimeve të parregullta të kryera në rubrikën “Përshkrimi i veçantë” me referencat nr. 026 etj të KPP pasuria nr. 7, v. 2, fq. 179 dhe shënimet e kryera me referencat nr. 0186, nr. 1037 në listën e bashkëpronarëve bashkëlidhur kësaj KPP-je.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 6.

ZVRPP Gjirokastrë dhe ZQRPP Tiranë të marrin masat për eliminimin e bashkëpronësisë së paligjshme në 78 Kartela Pasurie të Paluajtshme (KPP) në 12 zona kadastrale për 12 fshatra, të përfshira në sistem në vitet 1999,2000,2001, me sipërfaqe me 1,357,447 m² ndarë: 151,335 m² arë, 253,902 m² vresht dhe 952260 m² pemëtore përkatësisht për 1107 Familje bujqësore Bashkëpronare, të kryejë menaxhimin e 12 zonave Kadastrale të identifikojë e çelë 1107 KPP-të në përputhje me AMTP dhe listat përkatëse si dhe të rekomandojë e zbatojë rrugën administrative të zgjidhjes së bashkëpronësisë në bashkëpunim me DAMT e NJQV pasqyruar në tabelën “Pasuritë Bujqësore Në Bashkëpronësi Për Disa Zona Kadastrale”.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 7.

Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë të marrë masa, për të inventarizuar dhe çelur dosjet përkatëse për 42 kërkesa për informacion, verifikim, konfirmim gjendjes juridike të Titujve të pronësisë së tokës bujqësore (ndarë 3 jashtë juridiksioni dhe 39 në juridiksion, prej të cilave 17 janë pa përgjigje dhe 20 kërkesa me përgjigje të pa sakta e të pa plota); gjithashtu për 8 Kërkesa që ZVRPP Gjirokastrë ka drejtuar KVVTP për verifikim e vlerësim të titujve të pronësisë, prej të cilave 4 janë me përgjigje dhe 4 kërkesa nuk kanë përgjigje të KVVTP); të konfirmojë realisht dhe saktësisht gjendjen juridike të pasurive me AMTP sikundër trajtuar në Raport, pasqyruar në tabelën: “Marredheniet KVVTP-ZVRPP dhe anasjelltas për vlerësimin e titujve të pronësisë me AMTP viti 2012-2015 ZVRPP Gjirokastrë viti 2012-2015”.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 11.

ZVRPP Gjirokastrë dhe ZQRPP Tiranë të kryejnë menaxhimin e ZK 2156 fshati Klishar sipas AMTP-ve për 414 pasuritë e llojit pemëtore, hyrë në sistem në janar 2001 të identifikojë, çelë dhe plotësojë 164 KPP të vol. 1 dhe 250 KPP të vol. 2, z. 2156 fshati Klishar të pasurive lloji pemëtore e pasuri të tjera bujqësore sipas AMTP-ve të disponuar nga K/familjarët e fshatit Klishar.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 13.

ZVRPP Gjirokastrë të marrë masa të nxjerrë urdhër të posaçëm të fshijë regjistrimet për 9 kontratat (kontratat nr. 2994 me 2 pasuri, nr. 1211 me 2 pasuri, nr. 1345 me 1 pasuri, nr. 1399 me 3 pasuri përkatësisht sipas tabelës I,II,III,IV,V,VI,VII, IX,X) me objekt dhënie përdorimi e qiraje në seksionin “D”, të KPP-ve të pasurive pasqyruar tabelën “**Kontrata dhënie përdorimi dhe qiraje të PPL Shtetërore e Publike të aplikuara për regjistrim dhe të regjistruara nga ZVRPP Gjirokastrë v. 2013, 2014 dhe 2015**”, të kthejë zyrtarisht dokumentacionin (kontratat e Përdorimit dhe Qirasë të regjistruara dhe të pa regjistruara v. 2015) personit fizik dhe Njësisë Qeverisjes vendore që ka juridiksionin, Bashkisë Gjirokastrë.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 14.

ZQRPP Tiranë dhe ZVRPP Gjirokastrë, të fillojnë procedurat ligjore,(të neglizhuar dhe pa zbatuara me parë me pasoja subjektive dhe cenimit të paanësisë së ZVRPP ndërmjet palëve), të hartojnë dokumentacionin përkatës ligjor dhe të ndjek procedurat ligjore dhe ecurinë e procesit gjyqësor, lidhur me 40 pasuri me sipërfaqe totale 17100,9 m² të llojit truall dhe ndërtesa ndarë: 12 pasuri me sipërfaqe 7360 m² në vitin 2009, 10 pasuri me sipërfaqe 3441 m² në vitin 2010, 7 pasuri me sipërfaqe 742,5 m² në vitin 2011, 5 pasuri me sipërfaqe 1694,9 m² në vitin 2012 dhe 6 pasuri me sipërfaqe 3862,5 m² në vitin 2013, pasuri këto të rezultuara me mbivendosje, në tabelën emërtuar:“Regjistrime pasurish me mbivendosje dhe transaksione pas datës 11.08.2008 mbi sipërfaqet e kthyer në VKKP nr. 134, datë 13.3.2008”.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 15.

Rekomandimi i lënë: ZVRPP Gjirokastrë të analizoje gjendjen e nxjerrë përgjegjësinë, të marrë masa të evidentojë,vendosë database dhe komunikojë atë brenda stafit, të krijojë hartat e pasurive të identifikuara me mbivendosje dhe të munguara si dhe të ndjekë e të raportojë ecurinë e procedurave ligjore të trajtimit pasurive të regjistruara me mbivendosje mbi prona të regjistruara me parë .

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 19.

Rekomandimi i lënë: ZVRPP Gjirokastrë të nxjerrë urdhër në bazë të nenit 25 germa (a) të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe nenit 193 të Kodit Civil...”, për fshirjen e regjistrimit nga pronësia e Komunës Cepo dhe regjistrimin “Shtet” të sipërfaqes lumore prej 2,79 ha, përkatësisht tre pasurive nr. 477/4,v. 3, f. 179, zk. 3058, lloji kullotë në fakt (Lumë) me sipërfaqe 16740 m² (1,67 ha), nr. 226/2,v. 3, f. 178 zk. 3058, lloji Kullotë me sipërfaqe 9512 m² (0,95 ha) dhe nr. 477/5,v. 3, f. 180 zk. 3058, lloji Lumë, me sipërfaqe 1748 m² (0,17 ha) të ndodhura në shtratin e lumit Kardhiq me përgjegjësi administrative dhe me status juridik përdorimi MMPAU (Ministria e Mjedisit Peshkimit dhe Administrimit të Ujërave).

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 23.

Rekomandimi i lënë: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë të kërkojë saktësimin e listave të kryefamiljarëve, gjendje e vitit 1991, për ZK nr. 2392, të cilët posedojnë banesa sipas listave 001 dhe deri në saktësimin e gjendjes së pasurive të marrë masa që të mos kryhet asnjë veprim dhe konkretisht për pasuritë nr. 462, volum 9, faqe 188; nr. 617, volum 10, faqe 94; nr 705, volum 10, faqe 181; nr. 713, volum 10, faqe 189, nr. 471, volum 9, faqe 197; nr. 722, volum 10, faqe 198; nr. 737, volum 10, faqe 21; nr. 740, volum 10, faqe 216; nr. 745, volum 10, faqe 221; nr. 748, volum 10, faqe 224; nr. 976, volum 11, faqe 201; nr. 1175, volum 12, faqe 137; nr. 462, volum 9, faqe 188.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 24.

Rekomandimi i lënë: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë të kërkojë saktësimin e listave të VKM nr. 748, datë 28.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, ish-komuna Cepo, të Qarkut Gjirokastrë” përfshirë këtu dhe pasurinë nr. 28/5, volum 4, faqe 1, në ZK nr. 2989, fshati Plasat Gjirokastrë.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 30.

Rekomandimi i lënë: Nga ZVRPP Gjirokastër në bashkëpunim me ZQRPP të merren masa të menjëhershme për administrimin e listave printim III me kryefamiljarë për zonat kadastrale që mungojnë, të përpilohen inventarët e AMTP-ve të marra në dorëzim, si dhe administrohen fizikisht AMTP për zonat të cilat mungojnë, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr. 556, datë 23.10.2000 “Për dorëzimin e dokumentacionit të pronësisë në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 32.

Rekomandim i lënë: Nga ana e ZQRPP-së të merren masa të menjëhershme për krijimin ambienteve dhe kushteve të mjaftueshme për ushtrimin e veprimtarisë dhe ecurinë normale të procesit të regjistrimit të pasurive nga ZVRPP Gjirokastër, si dhe ruajtjen e administrimin e dokumentacionit në mënyrë të sigurt (*dokumente që kanë afat ruajtje të përjetshme*) në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Rregulloren nr. 184, datë 18.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme” dhe Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 33.

Rekomandim i lënë 33: Nga ZVRPP Gjirokastër në bashkëpunim me ZQRPP të merren masa për përfundimin e procesit të hedhjes së zonave në sistem, administrimin e dokumentacionit si listë printime, hartë treguese dhe volume si dhe zëvendësimin e menjëhershëm të hartave të dëmtuara të zonave kadastrale.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 35.

Rekomandimi i lënë: Nga ZVRPP Gjirokastër t’i kërkohet Këshillit të Qarkut Gjirokastër plotësimi i AMTP-ve me të dhëna të sakta në përputhje me Vendimin e Gjykatës Nr. 464, datë 17.09.2015 si dhe certifikatave të gjendjes civile të personave që i posedojnë ato si dhe përcjellja me shkresë e AMTP-së që mungon.

Nga ZVRPP Gjirokastër të merren masa për vendosjen e kufizimit për pasuritë të cilat janë regjistruar me AMTP dhe të cilat kanë mospërputhje me vendimin e Gjykatës deri në saktësimin e të dhënave.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 39.

Rekomandimi i lënë: ZQRPP dhe ZVRPP Gjirokastër të kërkojnë pranë Ministrit Drejtësisë që nëpërmjet strukturave të shqyrtojë Vendimin e Gjykatës nr. 464, datë 17.09.2015, për bazueshmërinë ligjore të trajtimit me tokë të disa personave, për shkak të kufizimit ligjor të trajtimit nga KLSH të çështjes, sepse ka kaluar zgjidhja e çështjes në rrugë administrative nga KLSH dhe tashmë i është nënshtruar rrugës gjyqësore. Opinioni i KLSH në lidhje me këtë është i pamundur të jepet pasi rruga fundore është çuarja në Gjykatë.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 41.

Nga ana e ZVRPP Gjirokastër të kërkohet saktësimi i listave të kryefamiljarëve, gjendje e vitit 1991, të cilët posedojnë banesa sipas listave 0001, dhe deri në saktësimin e gjendjes së

pasurive të marr masa që të mos kryhet asnjë veprim në pasuritë si vijon: - Pasuria nr. 2580, vol 17, fq. 244, zk. 2392; Pasuria nr. 3032, vol 19, fq. 195, zk. 2392; Pasuria nr. 3026, vol. 19, fq. 189, zk. 2392; Pasuria nr. 2960, vol 19, fq. 123, zk. 2392; Pasuria nr. 2882, vol. 19, fq. 45, zk. 2392; Pasuria nr. 2885, vol 19, fq. 48, zk. 2392; Pasuria nr. 2942, vol 19, fq. 105, zk. 2392; Pasuria nr. 3213, vol 20, fq. 125, zk. 2392 ; Pasuria nr. 3296, vol 20, fq. 208, zk. 2392 ; Pasuria nr. 3339, vol 21, fq. 1, zk. 2392; Pasuria nr. 3400, vol 21, fq. 62, zk. 2392.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 43.

Rekomandimi i lënë: Nga ZVRPP Gjirokastrë të kërkohet saktësimi i listave të kryefamiljarëve, gjendje e vitit 1991, të cilët posedojnë banesa sipas listave 0001 dhe deri në saktësimin e gjendjes së pasurive të marr masa që të mos kryhet asnjë veprim në pasuritë si vijon: - Pasuria 84/27, vol. 8, fq. 160, zk. 2392; Pasuria 84/2, vol. 8, fq. 137, zk. 2392; Pasuria 84/3, vol. 8, fq. 138, zk. 2392; Pasuria 84/29, vol. 8, fq. 162, zk. 2392; Pasuria 84/89, vol. 8, fq. 222, zk. 2392; Pasuria 84/28, vol. 8, fq. 161, zk. 2392; Pasuria 1312, vol. 13, fq. 24, zk. 2392; Pasuria 979, vol. 11, fq. 204, zk. 2392; Pasuria 2113, vol. 16, fq. 32, zk. 2392; Pasuria 2886, vol. 19, fq. 49, zk. 2392; Pasuria 2889, vol. 19, fq. 52, zk. 2392; Pasuria 3036, vol. 19, fq. 199, zk. 2392; Pasuria 3329, vol. 20, fq. 241, zk. 2392

- Të lihen të lira vetëm njëra nga pasuritë për çdo person dhe konkretisht pasuria 2484, vol. 17, fq. 148, zk. 2392; pasuria 2470, vol. 17, fq. 134, zk. 2392; pasuria 2684, vol. 18, fq. 98, zk. 2392; pasuria 2211, vol. 16, fq. 130, zk. 2392, për të cilat nuk është kërkuar të mos kryhen veprime si më sipër, pasi nuk janë konstatuar diferenca në sipërfaqe nga ajo e përcaktuar në listën e trojeve.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 61.

Rekomandimi i lënë: ZVRPP Gjirokastrë të marrë masa për kërkimin e informacionit lidhur me përcaktimin e statusit ligjor të "F" dhe mbi bazën e njohjes së këtij statusi të njoftojë KLSH-në, i cili nga ana e vetë pasi ta vlerësojë atë, rezervon të drejtën e dhënies së një rekomandimi lidhur me nxjerrjen e urdhrin të kufizimit për trojet e regjistruara në pronësi të shoqërisë A shpk, si troje të shitura pa qenë të regjistruara në pronësi të Komunës dhe në kundërshtim me ligjin 7980, datë 27.07.1995 "Për shitblerjen e trojeve" dhe me VKM nr. 364, datë 05.10.1991, pika 1, si dhe për pasaktësitë evidentuar në këtë projekt në lidhje me sipërfaqen e regjistruar me diferencë më tepër prej 3769 m² truall dhe diferencë sipërfaqe ndërtimi regjistruar më tepër për 5296 m² për objektin "F" pa dokumentacionin e duhur ligjor nga privatizimi dhe lejet e ndërtimit, në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", për shkeljet e konstatuara.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 66.

Rekomandimi i lënë: ZVRPP Gjirokastrë të marrë masa për nxjerrjen e urdhrin për kufizimin e regjistrimeve të pasurive të ndodhura brenda pasurisë së përcaktuar për kthim në pronësi të Kryegjyshitës sipas vendimit të KKP nr. 134, datë 13.03.2008 në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" dhe të zbatoje urdhrin për regjistrimin në pronësi të Kryegjyshitës të pasurive të kthyera në sipërfaqen prej 271631 m² të llojit troje të lira evidentuar në pasqyrën 11, dhe përcaktuar në hartën e punës së ZVRPP Gjirokastrë administruar për këtë qëllim si troje të lira.

Brenda muajit Mars 2017

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandimi 1.

ZVRPP Gjirokastrë, Regjistruesi të njoftojë Bashkinë Gjirokastrë për masat e marra (rekomanduar masa org. nr. 12 më sipër), urdhrin e fshirjes së regjistrimit për **9 kontratat** (kontratat nr. 2994 me 2 pasuri, nr. 1211 me 2 pasuri, nr. 1345 me 1 pasuri, nr. 1399 me 3 pasuri përkatësisht sipas tabelës I,II,III,IV,V,VI,VII, IX,X) dhe të ndiqen hapat ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **432,300** lekë nga e cila **300,000 lekë** kamatë vonesa viti 2013 për ZVRPP dhe për Bashkinë Gjirokastrë vlera 132,300 lekë qera dhe tatim qiraje për kontratat e v. 2013-2014 ndaj personave qiramarrës pasqyruar në tabelën “Përmbledhëse PPL Shtetërore Publike sipas llojit për regjistrim Kontrata përdorimi e qiraje dhe dëmet ekonomike të pa aplikuar nga ZVRPP Gjirokastrë v. 2013, 2014 dhe 2015”.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 3.

Rekomandimi i lënë: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë, të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej **320,854 lekë** ndarë: **14,000 lekë** për pasuritë nr. 10/42, volum 2, faqe 71, nr. 25/67, volum 4, faqe 211, nr. 26/109, volum 5, faqe 72 dhe nr. 83/40, volum 8, faqe 121, bashkëlidhur referencës 0295, në ZK nr. 2392 Lazarat; **11,000 lekë**, për pasurinë nr. 10/9, volum 7, faqe 87, në ZK nr. 8542 Gjirokastrë, sipas referencë nr. 02360; **192,430 lekë**, për pasurinë nr. 17/37, volum 6, faqe 222, në ZK nr. 8542 Gjirokastrë, sipas referencë nr. 02077; **21,314 lekë**, për pasurinë nr. 2/213, volum 7, faqe 187, në ZK nr. 8542 Gjirokastrë, sipas referencë nr. 02677 dhe **81,200 lekë**, për pasurinë nr. 2067, volum 2, faqe 85, në ZK nr. 2781, fshati Nepravishtë Gjirokastrë, sipas referencë nr. 0037, deri në pagesën e plotë të vlerave.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 4.

Rekomandimi i lënë: Nga ana e ZVRPP Gjirokastrë të merren masa për kufizimin e pasurisë nr. 3032, vol. 19, fq. 195, zk. 2392 deri në arkëtimin e vlerave të konstatuara si dëm ekonomik më sipër në përputhje me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60. Gjithashtu të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimin e shumës **320,999 lekë** shkaktuar nga kamata vonesa dhe mos kërkimi i likuidimit të vlerës ndërtimore.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 5.

Rekomandimi i lënë: Nga ana e ZVRPP Gjirokastrë të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **128,744 lekë** për shitjen e pronës shtetërore në sipërfaqe totale **418 m²**, nga personat përgjegjës si më poshtë:

- z. *L. Xh.*, me detyrë ish-Specialist Hartograf dhe z. *A. P.* me detyrë ish-regjistruesi për vlerën **52,360 lekë**.

- z. *K. K.* me detyrë ish-Specialist Hartograf dhe z. *J. R.i* me detyrë ish-regjistruesi për vlerën **34,188 lekë**,

- z. *I. B.* me detyrë ish-Specialist Hartograf dhe z. *S. J.* me detyrë ish-regjistruesi për vlerën **20,636 lekë**,

- z. *Th. C.* me detyrë ish-Specialist Hartograf dhe z. *N. D.* me detyrë ish-regjistruesi për vlerën **21,560 lekë**.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 6.

Rekomandimi i lënë: Nga ana e ZVRPP Gjirokastrë të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 15,000 lekë e ardhur nga shmangia e pagesës së taksës për kalimin e pronësisë, si dhe të mos kryej asnjë veprim mbi pasuritë përkatëse deri në dorëzimin e dokumentit që vërteton pagesën.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 7.

Rekomandimi i lënë: Nga ana e ZVRPP Gjirokastrë të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 100,000 lekë për shitjen e pronës shtetërore në sipërfaqe totale 10 m², nga personat përgjegjës si më poshtë:

- z. *L.Xh.*, me detyrë ish-Specialist Hartograf për vlerën 33,333 lekë
- z. *D. P.* me detyrë ish-Specialist Jurist për vlerën 33,333 lekë
- z. *K. M.* me detyrë ish-Regjistruer për vlerën 33,333 lekë.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 8.

Rekomandimi i lënë: Nga ana e ZVRPP Gjirokastrë të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 30,954 lekë e ardhur nga shmangia e pagesës së taksës për kalimin e pronësisë, si dhe të vendosë kufizimin mbi pasurinë nr. 30/3, vol 3, fq. 136, zk. 3701-Valare deri në dorëzimin e dokumentit që vërteton pagesën.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 9.

Rekomandimi i lënë: Nga Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 303,500 lekë e ardhur nga mos llogaritja e kamat vonesës si dhe tarifës për regjistrimin e Vendimit të Gjykatës, si dhe nxjerrjen e urdhrit të kufizimit mbi pasurinë nr. 108/16, vol. 2, fq 61, zk. 3535, Suhe në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, deri në likuidimin e vlerës.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 10.

Rekomandimi i lënë: Nga Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 60,000 lekë e ardhur nga mos llogaritja e kamat vonesës për regjistrimin e Vendimit të KKKP-së, si dhe nxjerrjen e urdhrit të kufizimit mbi pasuritë:

- nr. 3684, vol. 22, fq. 96, zk. 2392,
- nr. 3055, vol 19, fq. 217, zk. 2392,

në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, deri në likuidimin e vlerës.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 11.

Rekomandimi i lënë: Nga ana e ZVRPP Gjirokastrë të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 52,000 lekë ardhur nga shitja e pronës shtetërore në sipërfaqe totale 321 m², nga personat përgjegjës si më poshtë:

- z. *L. Xh.*, me detyrë ish-Specialist Hartograf për vlerën 26,000 lekë
- z. *N. D.*, me detyrë ish-Regjistruer për vlerën 26,000 lekë.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 12.

Rekomandim i lënë: Nga Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 300,000 lekë e ardhur nga mos llogaritja e kamat vonesës për regjistrimin e vonuar të lejes së përdorimit nr. 3, datë 12.11.2013, si dhe nxjerrjen e urdhrit të kufizimit në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, mbi pasurinë nr. 70/76, vol. 7, fq. 46, zk. 3701 deri në likuidimin e vlerës.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 13.

Rekomandim i lënë: ZVRPP Gjirokastrë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkojë rrugë ligjore arkëtimin e detyrimit prej 2,560,300 lekë, sipas pasqyrës 4 bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

Brenda muajit Mars 2017

5. NË AGJENCINË E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE NDËRTIMEVE INFORMALE (ALUIZNI) ELBASAN.

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë e vlerësues i aktivitetit të institucionit” për periudhën 01.10.2013 deri 28.02.2016, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 58, datë 30.05.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 130/7, dt. 30.05.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria e ALUIZNI-t Elbasan ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve, me shkresën përcjellëse nr. 1206/115, datë 15.06.2016,, me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Në zbatim të pikës 2, neni 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria e ALUIZNI-t Elbasan ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve, me shkresën përcjellëse nr. 1026/124, dt. 30.11.2016,, me njoftim për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë **21** rekomandime gjithsej, nga këto: **9** masa organizative, **4** masë zhdëmtimi me vlerën **164,443,016** lekë dhe **8** masa disiplinore (Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës nga “Vërejtje me paralajmërim” deri “Zgjidhje të kontratës së punës”).

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **9** masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht **9**, nga të cilat janë zbatuar 7, është në proces zbatimi 1 rekomandim dhe është ezuaruar 1 rekomandim, për shkak të ndryshimeve ligjore.

b. Për shpërblim dëmi janë lënë **4** rekomandime për shumën **5,302,119** lekë, nga të cilat, janë pranuar **4**. Janë zbatuar 2 rekomandime në vlerën **48,907** lekë janë zbatuar pjesërisht 2 duke arkëtuar detyrimin financiar në vlerën **462,714** lekë, mbetet në proces arkëtimi i vlerës prej **4,790,498** lekë.

c. Mbështetur në nenin 154 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 11 e 12 të Kontratës individuale të punës janë rekomanduar: **8** masa disiplinore nga të cilat 2 masa disiplinore “Zgjidhje të kontratës së punës” dhe 1 masë “Vërejtje me shkrim”, si dhe 5 masa disiplinore “Vërejtje” deri në “Zgjidhjen e Kontratës së Punës, lidhur me nivelin e zbatimit të tyre sipas informacionit të Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan, janë zbatuar 2 rekomandime.

Eprori direkt, në këtë rast nuk është Drejtoria e ALUIZNI-t, Elbasan, por Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, Tiranë, e cila ka kompetencën për dhënien e masave disiplinore.

Në përfundim rikërkojmë nga Drejtoria e ALUIZNI-t, Elbasan përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 130/7, datë 30.05.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara.

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 4.

Drejtorja Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi, të fillojë procedurat, për rishikimin dhe shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Brenda muajit Mars 2017

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandimi 1.

Drejtorja Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për llogaritjen, saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së parcelës ndërtimore prej **3,820,204 lekë**, ndajë personave: Sh. B. në shumën 708,523 lekë; Y.M. në shumën 322,019 lekë; Z.K. në shumën 303,841 lekë; A.H. në shumën 289,572 lekë; T.H., R.H. në shumën 87,631 lekë; Sh.S. në shumën 236,891 lekë; K.N. në shumën 58,444 lekë; N.A në shumën 205,042 lekë; F.D. në shumën 390,541 lekë; A.M. në shumën 645,216 lekë; A.R. në shumën 158,748 lekë; G.V. në shumën 316,536 lekë dhe Xh. Gj. në shumën 28,000 lekë.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 3.

Rekomandimi: Drejtoria e ALUIZNI-t Elbasan, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 960,000 lekë, nga operatori ekonomik “L” me përfaqësues ligjor z. L.Z..

Brenda muajit Mars 2017

6. ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURISË TË PALUAJTSHME SHKODER.

Nga auditimi i ushtruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë të Paluajtshme (ZVRPP) Shkodër, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” për periudhën 01.01.2014 deri 30.09.2015 trajtuar në

Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.177, datë 29.16.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 702/25, datë 11.04.2016, konstatohet se: Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë të Paluajtshme, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 5838/7, dt. 25.01.2016 ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë të Paluajtshme (ZVRPP) Shkodër, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve të KLSH, me shkresën përcjellëse nr. 3160, dt. 8.04.2016.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 78 rekomandime gjithsej, nga këto: 63 masa organizative dhe 4 masë zhdëmtimi me vlerën 5,868,510 lekë, si dhe 16 masa disiplinore, nga të cilat 11 masa “Vërejtje me paralajmërim” dhe 5 masa për “Zgjidhje të kontratës së punës”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 63 masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 63, janë zbatuar 57 rekomandime dhe janë në proces zbatimi 6 rekomandime.
- b) Për shpërblim dëmi janë lënë 4 rekomandime për shumën 5,868,510 lekë të arkëtueshëm, të cilat, janë pranuar, dhe janë në proces zbatimi 4 rekomandime në vlerën 4,549,010 lekë dhe arkëtuar 1,319,500 lekë.
- c) Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës janë rekomanduar: 11 masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” dhe 4 masa “Zgjidhja e kontratës individuale”, nga cilat janë zbatuar 14 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë.

Në përfundim **rikërkojmë** nga ZVRPP Shkodër, përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 702/20, dt. 29.12.2015, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara.

A. MASA ORGANIZATIVE

21. Rekomandimi:

- Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të marrë masa, të vendosi datë përfundimtare në kartelat e pasurisë së paluajtshme volumin 31 ZK 8591, ZK 3205, ZK 3838.

Menjëherë

22. Rekomandimi:

-Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të marrë masa, që për çdo rast të verifikohen e elementët e formës dhe të përmbajtjes duke plotësuar shtojca 1, 2, 3.

Në vijimësi

23. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të marrë masa, që për çdo rast të përgatitur planrilevimi nga hartografi i ZVRPP duke e krahasuar me planrilevimin e ardhur nga topografi me licencës.

Në vijimësi

24. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 7/367 volum 37 faqe 153; nr. 1/780 volum 37 faqe 158; nr. 7/442 volum 37 faqe 152; nr. 1/771 volum 37 faqe 145; nr. 8/437 volum 37 faqe 110; nr. 7/371, volum 37 faqe 91; nr. 1/782(është nr. 1/781), volum 37 faqe 89; nr. 2/897+1-2 volum 37 faqe 84; nr. 4/630 volum 37 faqe 75; nr. 4/632 volum 37 faqe 77; nr. 7/404 volum 37 faqe 164; nr. 8/390, volum 37 faqe 165(pasuri shtet), nr. 5/702 volum 37, faqe 202 (nuk identifikohet pasi në vol. 37, faqe 202 rezulton pasuria apartament), nr. 12/8123(është nr.2/813), volum 36, faqe 17, nr. 2/851, volum 37, faqe 236, nr. 5/698, volum 37, faqe 242, nr. 1/778, volum 38, faqe 9, nr. 1/777, volum 38, faqe 11, nr. 1/714, volum 38, faqe 7, nr. 9/1299(është 9/299), volum 38, faqe 19, nr. 4/619, volum 38, faqe 35, nr. 9/298, volum 38, faqe 45, nr. 6/566, volum 36, faqe 110, nr. 2/942, volum 36, faqe 85, nr. 12/446, volum 36, faqe 84, nr. 2/964, volum 36, faqe 83, nr. 5/753, volum 36, faqe 70, nr. 5/616, volum 36, faqe 69, nr. 10/693, volum 36, faqe 139, nr. 10/839, volum 36, faqe 137, nr. 8/360, volum 36, faqe 133, nr. 10/704, volum 36, faqe 131, nr. 2/936, volum 36, faqe 135, nr. 12/430, volum 36, faqe 138, ZK 8594, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2017

27. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 7/367, volum 37, faqe 153, nr. 1/780, volum 37, faqe 158, nr. 7/442, volum 37, faqe 152, nr. 1/771, volum 37, faqe 145, nr. 8/437, volum 37, faqe 110, nr. 7/371, volum 37, faqe 91, nr. 1/782(është nr. 1/781), volum 37, faqe 89, nr. 2/897+1-2, volum 37, faqe 84, nr. 4/630, volum 37, faqe 75, nr. 4/632, volum 37, faqe 77, nr. 7/404, volum 37, faqe 164, nr. 8/390, volum 37 faqe 165(pasuri shtet), nr. 5/702 volum 37, faqe 202(nuk identifikohet pasi në vol. 37, faqe 202 rezulton pasuria apartament), nr. 12/8123(është nr. 12/823), volum 36, faqe 17, nr. 2/851, volum 37, faqe 236, nr. 5/698, volum 37, faqe 242, nr. 1/778, volum 38, faqe 9, nr. 1/777, volum 38, faqe 11, nr. 1/714, volum 38, faqe 7, nr. 9/1299(është nr. 9/299), volum 38, faqe 19, nr. 4/619, volum 38, faqe 35, nr. 6/566, volum 36, faqe 110, nr. 2/942, volum 36, faqe 85, nr. 12/446, volum 36, faqe 84, nr. 2/964, volum 36, faqe 83, nr. 5/753, volum 36, faqe 70, nr. 5/616, volum 36, faqe 69, nr. 10/693, volum 36, faqe 139, nr. 10/839, volum 36, faqe 137, nr. 8/360, volum 36, faqe 133, nr. 10/704, volum 36, faqe 131, nr. 2/936, volum 36, faqe 135, nr. 12/430, volum 36, faqe 138, ZK 8594, pasurinë nr. 8/573, volum 42, faqe 123, nr. 9/1024, volum 43, faqe 146, nr. 8/590, volum 42, faqe 225, nr. 9/1003, volum 43, faqe 91, nr. 9/267, volum 41, faqe 187, ZK 8593, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2017

28. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 9/998 (është pas. nr. 9/982, e tjetërsuar tek të tretet), volum 42, faqe 216, nr. 8/573, volum 42, faqe 123, nr. 9/1024, volum 43, faqe 146, nr. 8/590, volum 42, faqe 225, nr. 9/1003, volum 43, faqe 91, nr. 9/267, volum 41, faqe 187, ZK 8593, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Mars 2017

C. MASË PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimi i shumës **2,588,000 lekë**, për:

- Sipas pasqyrës nr. 4 në shumën 2,080,000 lekë tarifa për kartelat e pasurisë së paluajtshme dhe regjistrim pasurie të pa arkëtuara për periudhën 01.01-30.12.2013.
- Sipas pasqyrës nr. 5 në shumën 314,000 lekë tarifa për kartelat e pasurisë së paluajtshme të pa arkëtuara për periudhën 01.01-30.12.2014.
- Sipas pasqyrës nr. 6 në shumën 194,000 lekë tarifa për kartelat e pasurisë së paluajtshme të pa arkëtuara për periudhën 01.01-30.06.2015.

Brenda muajit Mars 2017

2. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës **42,210 lekë** për z. B.D..

Brenda muajit Mars 2017

3. Rekomandimi:

- Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Shkodër të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës **300,000 lekë**.

Brenda muajit Mars 2017

4. Rekomandim: Të kontabilizohet dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej 2,461,000 lekë nga 11 subjekte (*sipas tabelës përkatëse*).

Brenda muajit Mars 2017

7.NË ZYREN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME KUKËS

Nga auditimi i ushtruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë të Paluajtshme (ZVRPP) Kukës, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” për periudhën 01.01.2014 deri 31.12.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 71, dt. 29.06.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr.311/9, datë 30.06.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 2884, datë 20.07.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ZVRPP Kukës, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 1997/1, datë 28.07.2016 ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

1. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 54 masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 53, nga këto të përfunduara 35, në proces zbatimi 18, nuk është pranuar 1.

2. *Për shpërblim dëmi është lënë 10 rekomandime për shumën 18,177,277 lekë, në procedurë.*
3. *Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës janë rekomanduar: 4 masa disiplinore nga “Vërejtje me paralajmërim” deri “Largim nga detyra” nga të cilat 4 janë pranuar, lidhur me zbatimin e tyre sipas informacionit të ZQRPP Tiranë, janë zbatuar 3 rekomandime.*

Në përfundim rikërkojmë nga Zyren Vendore të Regjistrimit të Pasurisë të Paluajtshme (ZVRPP) Kukës, përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 2884, datë 20.07.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht.

A. MASA ORGANIZATIVE

8. Rekomandimi:

ZVRPP Kukës, Regjistruesi të marrë masa të identifikojë dhe të çelë KPP për 6 pasuri me sipërfaqe faktike 1848 m² të llojit truall ndodhur në zk 2039 Kalimash, dhe gjithashtu të identifikojë qartë në KPP-të e çelura emërimin dhe subjektin që ka nën administrim për 57 pasuri shtetërore troje e ndërtesa të ndodhura në zk 2039 Kalimash, pasqyruar në tabelën emërtuar “Pasuri Truall me sipërfaqe tepër mbi normë me lista 001, Lëshuar certifikata dhe kryer transaksione në KPP zk 2039 Kalimash Kukës”

Brenda muajit Mars 2017

11/13. Rekomandimi:

ZVRPP Kukës të kërkojë pranë ish NJQV-ve dhe aktualisht pranë Bashkisë Kukës që nëpërmjet Njësive Administrative të hartonin listat e munguara dhe të pa dorëzuara të trojeve 001 sipas gjendjes së vitit 1991 për 3 fshatra si zk. 2290, Fshati Kryemadh me 124 K/Familjarë, me 114 troje të evidentuar të përfshira brenda AMTP-ve, në ZK. 1697 fshati Gëdheshite me 74 K/Familjarë me 58 troje të evidentuar të përfshira brenda AMTP-ve; dhe në ZK. 3406 Fshati Shpat me 44 K/Familjarë me 36 nga 44 troje të evidentuar të përfshira brenda AMTP-ve sipas ne tabelës emërtuar “**B. Fshatra dhe 30 ZK që Nuk kanë Lista 001 por trojet i kanë përfshirë brenda Kolonave të AMTP-ve**”.

Brenda muajit Mars 2017

12. Rekomandimi:

Nga auditimi me zgjedhje i listave të trojeve 001 të administruara nga ZVRPP Kukës për fshatrat që kanë hartuar e dorëzuar këto lista rezulton se për 629 K/Familjarë sipas listave 001 shënohet sipërfaqja në fakt prej 261611 m², e cila krahasuar me normën prej 300 m² me sipërfaqe normë totale 133400 m²truall, tregon se këto lista përmbajnë sipërfaqe tepër +128211 m² truall, që vjen nga pajisja me 2 e më shumë troje për K/Familjar dhe nga sipërfaqe mbi 300 m², gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012, dhe me nenin 10 të Dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978, datë 29.6.1978” Për Hartimin, Miratimin dhe Zbatimin e Planeve Rregulluese të Qyteteve dhe të Fshatrave”, ku shprehet “....Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore e në përdorim një ngastër deri në 200 m² në fshatrat kodrinore e malore deri në 300

m² dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri 170 m²...” pasqyruar në tabelën emërtuar “A. Fshatra dhe ZK me Sipërfaqe Trojesh mbi Normë sipas Listave 001 të Hartuara”

12/14. Rekomandimi:

-ZVRPP Kukës të kërkojë pranë ish NJQV-ve dhe aktualisht pranë Bashkisë Kukës nëpërmjet Njësive Administrative, verifikimin dhe saktësimin e listave të dorëzuara të trojeve 001 sipas gjendjes së vitit 1991 për **14 fshatra** me **629 K/Familjarë** ku sipas listave 001 shënohet sipërfaqja në fakt prej **261611 m²** e cila krahasuar me sipërfaqen prej 133400 m² sipas normës prej 300 m² tregon se këto lista përmbajnë sipërfaqe tepër +128211 m² truell që vjen nga pajisja me 2 e më shumë troje për të njëjtin K/Familjar dhe nga sipërfaqe mbi 300 m², pasqyruar në tabelën emërtuar “A. Fshatra dhe ZK me Sipërfaqe Trojesh mbi Normë sipas Listave 001 të Hartuara”.

Brenda muajit Mars 2017

13. Rekomandimi:

ZVRPP Kukës dhe ZQRPP Tiranë kanë pranuar nga Njësia e Menaxhimit të Projektit (NjMP) (në vitin 1995 kur zona ka hyrë në Sistemin e regjistrimit fillestar) dokumentacionin me mangësi për **ZK 1176 Fshati Breglumë** Printim III me gabime dhe librat e KPP-ve 2 volume duke lënë jashtë menaxhimit në sistem dhe pa çelur KPP për **194 pasuri** me sipërfaqe **119526 m² ose 12 ha tokë bujqësore arë pemëtore**, që i përkasin **222 AMTP-ve** ndërkohë që kanë çelur KPP për **256 troje** (sipërfaqe të përfshira brenda AMTP-ve, dhe pa pasur listën e trojeve 001 të konfirmuar nga Kryeplaku dhe Kryetari Komunes), gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën” dhe me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

13/15 Rekomandimi:

ZVRPP Kukës dhe ZQRPP Tiranë të kryejnë menaxhimin dhe futin në sistem, të identifikojnë pasuritë e të çelin KPP-të për **194 pasuri** me sipërfaqe **119526 m² tokë bujqësore** që i përkasin **222 AMTP-ve** në **ZK1176 Fshati Breglumë** si dhe të kërkojnë pranë NJQV, Bashki Kukës konfirmimin e listës 001 së **256 trojeve** për të cilat janë çelur KPP.

Brenda muajit Mars 2017

14. Rekomandimi:

ZVRPP Kukës nuk ka çelur KPP, PIII dhe nuk ka bërë azhurnimin që u përkasin **32 ZK-ve** të menaxhuara në sistem deri në v.2004, për **255 AMTP-ve** me sipërfaqe **1,117,910 m² ose 111,79 ha** tokë bujqësore të dërguara nga Qarku pas viteve 2007-2014; për pasojë nuk janë menaxhuar këto pasuri të shpërndara në 453 parcela; gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën” dhe me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, i ndryshuar, me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, pasqyruar në tabelën emërtuar:” **TRAJTIMI I AMPT-ve SHTESE dhe NEVOJAT PER MENAXHIM E ÇELJE KPP**”.

Brenda muajit Mars 2017

14/16. Rekomandimi:

ZVRPP Kukës dhe ZQRPP Tiranë të kryejnë menaxhimin dhe futin në sistem, të identifikojnë pasuritë e të çelin KPP-të për **255 AMTP-të** me sipërfaqe **1,117,910 m² ose 111,79 ha** tokë bujqësore të dërguara nga Qarku pas viteve 2007-2014; të shpërndara në 32 zona kadastrale dhe 453 parcela pasqyruar në tabelën emërtuar:” **TRAJTIMI I AMPT-ve SHTESE dhe NEVOJAT PER MENAXHIM E ÇELJE KPP**”.

Brenda muajit Mars 2017

16/18. Rekomandimi:

ZVRPP Kukës, për vazhdimin e aplikimit nr. 3717, datë 28.12.2015 bërë nga subjekti "A.G.", Shpk, praktikë e mbetur në proces për regjistrimin e të drejtave të marrjes në përdorim të pasurive sipas VKM nr. 972, datë 2.12.2015, të bëjë identifikimin dhe të çelë KPP e pasurisë prej 29,5 ha, të shtrirë në ngastrat 92a, 92b, 93a, 93b, 94a, 94b të Ekonomisë Pyjore Mamëz-Kalimash, që kthehet në karrierë për aktivitet shfrytëzimi mineral shoqërisë "A G", SH.P.K, sipas VKM nr. 972, datë 2.12.2015 "Për Heqjen nga Fondi Pyjor dhe Kullor të Sipërfaqes, në Ngastrat e Ekonomisë Pyjore "Mamëz-Kalimash", të Rrethit Kukës, që do të Përdoret nga Shoqëria "A. G.", SH.P.K.

Brenda muajit Mars 2017

16/19. Rekomandimi:

ZVRPP Kukës, në përgjigjen e aplikimit nr. 3717, datë 28.12.2015 për regjistrimin e të drejtave të marrjes në përdorim të pasurive sipas VKM nr. 972, datë 2.12.2015, përveç sa kërkuar me shkresën nr.4, datë 05.01.2016, të kërkojë dhe dokumentacionin si më poshtë:

1. Dokumentacioni i shlyerjes së detyrimit për vlerën përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore për sipërfaqen 29,5 ha (pasi të identifikohen pasuritë e shtrira në ngastrat 92a, 92b, 93a, 93b, 94a, 94b të Ekonomisë pyjore "Mamëz-Kalimash"), nga shoqëria "A. G.", SH.P.K vlerësuar sipas pikës 4 të VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave"; në plotësim të detyrimit të pikës 2, të VKM nr. 972, datë 2.12.2015 ku shprehet: "Vlerat përkatëse të pakësimit të lëndës drusore të sipërfaqes së hequr e infrastrukturës së saj paguhen nga shoqëria "A. G.", SH.P.K në bazë të lidhjes 4, të VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", të ndryshuar.

2. Dokumentacioni i Planit të Rehabilitimit të sipërfaqes 88,5 ha fond pyjor brenda 3 vjetësh në ngastrat e përcaktuara, në Marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit, në plotësim të pikës 3 dhe pikës 4, të VKM nr. 972, datë 2.12.2015 ku shprehet: "Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria "A.G.", SH.P.K, detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen e marrë në përdorim, sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda 3 viteve të para të pyllëzojë me fondet e veta, një sipërfaqe prej 88,5 ha fond pyjor në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit".

Brenda muajit Mars 2017

17/20. Rekomandimi:

ZVRPP Kukës Regjistruesi të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 të njoftojë palët dhe orientojë zgjidhjen gjyqësore, përkatësisht :

a.-për pasuritë emërtuar **objekt oficinë** me sipërfaqe ndërtimi 190 m² e llojit ndërtesë 2kt regjistruar në regjistrin hipotekor nr.1, viti 1991, faqe 119, indeksi nr.11, datë 4.2.1994; në pronësi të Xh.C. transferuar në regjistrin hipotekor nr. 2 viti 1995-1996-1997, faqe 35, indeksi nr.55, datë 26.3.1998 në emër të A.E..

b.-për pasuritë emërtuar **objekt-magazinë oficine** me sipërfaqe ndërtimi 190 m² e llojit ndërtesë 2kt regjistruar në regjistrin hipotekor nr.2, viti 1995-1996-1997, faqe 21, indeksi nr. 14, datë 8.2.1996, në pronësi të B.E. dhe,

c.-për pasuritë emërtuar **objekt-zyra-Kapanone pasuria nr. 2/86-N, v.18, f.47 zk.2315 objekti me 395 m², me sipërfaqe tepër +11 m²** në emër të A.Z..

Brenda muajit Mars 2017

17/21. Rekomandimi:

ZVRPP Kukës Regjistruesi të marrë masa, për evidentuar raportuar relatuar gjendjen dhe regjistrimin e pasurive me mbivendosje , mbetur pa identifikuar evidentuar disa vite radhë, si dhe të zbatojë procedurat e duhura ligjore për trajtimin e pasurive regjistruar me mbivendosje.

Brenda muajit Mars 2017

18/22. Rekomandimi:

Rekomandim 22: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të marre masat për inventarizimin e dokumentacionit, dhe të evadohen aplikimet e **112** praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara prej 5 vitesh deri ne vitet 2015, të analizohen dhe kthehen të ardhurat e përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar përkatësisht 446 mijë lekë, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës së ZVRPP Kukës ndaj publikut, dhe të administrohen në arkivë dokumentacioni përkatës i praktikave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat”, neni 24, germa “b” dhe të neneve 4 e 5, Kapitulli II-të, për “Detyrat e Sekretar-Arkivit të organit shtetëror” dhe “Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore”, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjit nr.33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, rregullores nr. 2079, datë nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, sipas *tabelës “Përmbledhëse e Praktikave të papërpunuara dhe në proces dhe të ardhurat e përfituara shërbim prej para Vitet 2012- 2015”*,

Brenda muajit Mars 2017

18/23. Rekomandimi:

ZQRPP dhe ZVRPP Kukës të ndjekin hapat e duhur ligjor për instalimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të vendosin Sistemin e Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) si dhe të hartojnë, miratojnë e zbatojnë Rregulloren e brendshme të Funkionimit të Administratës së ZVRPP Kukës, si njësi e vetme në territorin vendor, bazuar ne organikat dhe organigramën dërguar nga Kryeministri me urdhrat nr. 196, datë 4.8.2014 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Urdhrin nr. 33, datë 2.4.2013 të Kryeministrit”. Në Rregullore të përfshihen, përcaktohen, shkruhen, kushtet e pranimit, testimi fillestar të aftësive profesionale dhe trajnimit në vazhdim të punonjësve në ZVRPP, statusi i të punësuarve, përcaktimi i kryerjes së detyrave, ushtrimi i kompetencave dhe mbajtja e përgjegjësive për secilin specialist, Regjistrues, zv. Regjistrues juristëve dhe punonjës të tjerë, si dhe detyrimet lidhur me përgatitjen e evidencave informacionit në tërësi dhe administrimin e dokumentacionit; si dhe për të gjitha këto procese dhe të punësuar të përcaktohen e vendosen *SMKB (Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm)* masa këto të detyrueshme në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Brenda muajit Mars 2017

18/25. Rekomandimi:

Nga ZVRPP Kukës për ndryshimin e zërit kadastral të merren masa për nxjerrjen e urdhër kufizimit sipas pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor për miratimin e ndryshimit të zërit kadastral nga organet që e kanë në kompetencë.

Brenda muajit Mars 2017

21/26. Rekomandimi:

Nga ZVRPP Kukës të merren masa për nxjerrjen e urdhër kufizimit sipas pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të

Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe ti dërgohen AMTP nr. 10209 dhe 10244 për verifikimin e statusit ligjor të titujve të pronësisë nga Bashkia Kukës në zbatim të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 pika 2.2, shkronja “ç”.

Brenda muajit Mars 2017

34. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Kukës të marrë masa, dhe në bashkëpunim me ARRSH të hartojnë listat përfundimtare mbi konfirmimin e gjendjen juridike të pasurive të segmentit të rrugës Kalimash-Morinë, të bëhet propozimin për vendimin e KM si dhe të kryhet shpërblimi përfundimtar i pronarëve si dhe të inventarizojë sipërfaqen e rrugës dhe regjistrimin në pasuri shtet.

Brenda muajit Mars 2017

31/36. Rekomandimi:

ZVRPP Kukës në çdo rast të regjistrimit të pasurive të transferuara në administrim dhe në pronësi të institucioneve të pushtetit vendor të kërkoj saktësimin e sipërfaqeve të pasurive të kaluara në administrimin sipas VKM-ve përkatëse, emërtimin e tyre në përputhje me listën e inventarit, si dhe të plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm ligjor për regjistrimin e tyre në zbatim të kërkesave të Ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, si dhe Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Brenda muajit Mars 2017

32/37. Rekomandimi:

Nga ZVRPP Kukës të merren masa që në çdo rast për kryerjen e regjistrimeve sipas listave të trojeve të kontrollohet nëse dokumentacioni i përcjellë për regjistrim, përmbush të gjithë elementët e formës dhe përmbajtjes të një dokumenti ligjor në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Brenda muajit Mars 2017

35/41. Rekomandimi:

Nga ZVRPP Kukës të merren masa për verifikimin dhe saktësimin në bashkëpunim me Bashkinë Kukës të listave të kryefamiljarëve gjendje në vitin 1991, listave të trojeve për 21 zona kadastrale trajtuar më hollësisht në tabelën nr. 1, emërtuar “Fshatra dhe ZK me Sipërfaqe Trojesh mbi Normë sipas Listave 001 të Hartuara/Tabela Përmbledhëse” si dhe tabelat shoqëruese për çdo zonë kadastrale, në të cilat ka rezultuar një sipërfaqe prej 279447 m² mbi normë prej 300 m², pa u veçuar në shtet, në kundërshtim me dekretin e Presidentit nr. 5747 datë 29.06.1978, dhe Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, në ato raste kur me pasuritë janë kryer transaksione, si lëshim certifikatë pronësie, regjistrim dëshmie trashëgimie të vendoset masa e kufizimit në përputhje në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” deri në shfuqizimin e certifikatave të përfituar me tituj të paligjshëm pronësie dhe veçimin shtet të sipërfaqes tepër, ndërsa në rastet për KPP pa veprime të veçohet sipërfaqja tepër mbi normë.

Brenda muajit Mars 2017

36/42. Rekomandimi:

Nga ZVRPP Kukës të merren masa për identifikimin e 49 pasurive shtet, si dhe të pasurive të tjera objekte shtetërore të pidentifikuara deri më tani, duke bërë shënimet përkatëse në kartelat e pasurive në përputhje me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” dhe Udhëzimin metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

Brenda muajt Mars 2017

39/45. Rekomandimi:

Nga Regjistruesi i ZVRPP Kukës, të merren masat për nxjerrjen e urdhrit të kufizimit në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor mbi pasuritë si vijon - nr. 47/136, vol. 31, faqe 3, zk. 2315, - nr. 57/185, vol. 29, faqe 172, zk. 2315 dhe - nr. 39/36, vol. 12, fq. 161, zk. 2315.

Brenda muajt Mars 2017

40/46. Rekomandimi:

Nga ZVRPP Kukës të merren masa që në të gjitha rastet e ngjashme për regjistrimin e lejeve të legalizimit mbi pasuri truall në të cilat ka pasur ndërtime të vjetra, të zbatohet procedura duke kërkuar nga subjekti aplikues të dorëzohet dokumentacioni për prishjen e ndërtimit të vjetër si dhe të kryhen veprime të rregullta në KPP në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” dhe Udhëzimit metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

Brenda muajt Mars 2017

41/47. Rekomandimi:

Nga ZVRPP Kukës të merren masa që në të gjitha rastet e gabimeve në dokumentacionin e përcjellë nga ALUIZNI, nuk duhet të procedohet me regjistrimin e pasurisë deri në saktësimin e plotë të dokumentacionit, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, VKM nr. 258, datë 04.05.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara” dhe Udhëzimit nr. 2532, datë 21.04.2009, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituara sipas ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006; “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale”.

Brenda muajt Mars 2017

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbareme me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën totale **18,177,277 lekë**, si më poshtë:

1. Rekomandimi:

ZVRPP Kukës, Regjistruesi të njoftojë Bashkinë Kukës dhe Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) (rekomanduar masa org. nr.4, më sipër), për masat e marra zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë **426,309 lekë** shkaktuar buxhetit të shtetit nga shitja e

sipërfaqes “shtet” pa titull pronësie për 7 pasuri me sipërfaqe tepër +1919 m² tokë arë vlerësuar me çmimin korent të kontratave, sipas tabelave “Referencat dhe pasuritë me sipërfaqe tepër mbi te cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie z. 1328 Bushat”.

Brenda muajit Mars 2017

1/2. Rekomandimi:

Regjistruesi të njoftojë Bashkinë Kukës dhe Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) (rekomanduar masa org. nr.6, më sipër), për masat e marra zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë **209,981 lekë** shkaktuar buxhetit të shtetit nga shitja e sipërfaqes “shtet” pa titull pronësie për 4 pasuri me sipërfaqe tepër +3060 m² tokë arë vlerësuar me çmimin korent të kontratave, sipas tabelave “Referencat dhe pasuritë me sipërfaqe tepër mbi te cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie ZK 2039 Kalimash”.

Brenda muajit Mars 2017

1/3. Rekomandimi:

Regjistruesi të njoftojë Bashkinë Kukës dhe Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) (rekomanduar masa org. nr.9, më sipër), për masat e marra zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë **120,885 lekë** shkaktuar buxhetit të shtetit nga shitja e sipërfaqes “shtet” pa titull pronësie për 9 pasuri me sipërfaqe tepër +4704 m² tokë arë vlerësuar me çmimin korent të kontratave, sipas tabelave “Referencat dhe pasuritë me sipërfaqe tepër mbi te cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie zk 2724 Morinë”.

Brenda muajit Mars 2017

4. Rekomandimi:

Regjistruesi të njoftojë Bashkinë Kukës dhe Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) (rekomanduar masa org. nr.10, më sipër), për masat e marra zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë **649,350 lekë** shkaktuar buxhetit të shtetit nga shitja e pasurisë nr. 91/11 v.5 fq 235 zk. 2724 Morine me sip 781 m² tepër +481 m² sipërfaqes tepër “shtet” truall pa titull pronësie nga qytetari L.D. vlerësuar me çmimin korent të kontratës sipas tabelave “Referencat dhe pasuritë me sipërfaqe tepër mbi te cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie zk 2724 Morinë”

Brenda muajit Mars 2017

5. Rekomandimi: Nga ana e ZVRPP Kukës të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **180,462 lekë** për shitjen e pronës shtetërore në sipërfaqe totale 423 m², nga personat përgjegjës si më poshtë:

- z. **H.K.**, me detyrë ish-Specialist Hartograf për vlerën **123,169 lekë**, për tjetërsimin e sipërfaqes prej **138 m²**

- z. **R.K.**, me detyrë ish-Regjistruesi për vlerën **49,989 lekë**, për tjetërsimin e sipërfaqes prej **313 m²**

- z. **E.M.**, me detyrë ish-Specialist për vlerën **7,307 lekë**, për tjetërsimin e sipërfaqes prej **285 m²**.

Brenda muajit Mars 2017

2/6. Rekomandimi:

Nga Regjistruesi i ZVRPP Kukës, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **900,000 lekë** e ardhur nga mos llogaritja e kamat vonesës për regjistrimin e vonuar të lejes së përdorimit nr. 3, datë 12.11.2013, si dhe nxjerrjen e urdhrit të kufizimit në bazë të

nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, mbi pasurinë për pasuritë nr. 26/106, vol. 27, fq. 121, zk. 2315-Kukës Qytet, nr. 35/47+1-9D, vol. 28, fq. 78, zk. 2315-Kukës Qytet dhe nr. 33/45-ND, vol. 31, fq. 31, zk. 2315-Kukës Qytet deri në likuidimin e vlerës.

Brenda muajit Mars 2017

3/7. Rekomandimi:

Nga Regjistruesi i ZVRPP Kukës, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **45,990** lekë e ardhur nga tjetërsimi i pasurisë shtet si dhe mos pagesa e taksës mbi vlerën shitjes, gjithashtu të nxjerrë urdhër kufizimi në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, mbi pasuritë nr. 33/45, vol. 17, fq. 139, zk. 2315-Kukës Qytet dhe nr. 33/45-ND, vol. 31, fq. 31, zk. 2315-Kukës Qytet deri në likuidimin e vlerës.

Brenda muajit Mars 2017

4/8. Rekomandimi:

ZVRPP Kukës të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkojë rrugë ligjore arkëtimin e detyrimit prej **177,500 lekë, për 2 raste** të subjekteve ndërtues “A” shpk dhe A-K” shpk..

Brenda muajit Mars 2017

4/9. Rekomandimi:

ZVRPP Kukës në 4 rastet sipas refencave **nr. 019-0947, 050-0947, 053-0947, 053-944** më parë se të kërkohej arkëtimi i detyrimit prej **14,266,800 lekë** për pasuritë e regjistruara pa pasur AMTP të marrë masat e kufizimit deri në përcaktimin e statusit ligjor të pronësië nga Bashkia Kukës në zbatim të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 pika 2.2, germa “ç”.

Menjëherë

5/10. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Kukës, të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohej në rrugë ligjore arkëtimi i shumës **prej 1,200,000 lekë** përkatësisht: 300,000 lekë për pasurinë nr. 40/120, volum 28, faqe 189; shumës 300,000 lekë për pasurinë nr. 23/108, volum 28, faqe 28; shumës 300,000 lekë për pasurinë nr. 26/92, volum 29, faqe 62 dhe shumës 300,000 lekë për pasurinë nr. 40/123, volum 28, faqe 205, deri në pagesën e plotë të vlerave.

Menjëherë

8. NË ZYREN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DIBËR

Nga auditimi i ushtruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit Të Pasurisë së Paluajtshme Diber për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, nr. 1114/6 datë 04.11.2016 me “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” për periudhën 01.01.2014 deri 31.12.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit nr. 609/10, dt.26.09.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr nr. 3715 Prot , dt. 17.11.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Zyren Vendore të Regjistrimit Të Pasurisë së Paluajtshme Diber, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me 3715 Prot, dt. 17.11.2016, ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Zyren Vendore të Regjistrimit Të Pasurisë së Paluajtshme Diber është në proces për të kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga ana e subjektit është kthyer përgjigja me shkresën përcjellëse nr. 3715 Prot, dt. 17.11.2016, dhe tonën 609/10 Prot, dt. 26.09.2016 me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 45 rekomandime gjithsej, nga këto: 37 masa organizative dhe 8 masë zhdëmtimi me vlerën 110,086,000 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- 1. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 53 masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 53.*
- 2. Për shpërblim dëmi janë lënë 13 rekomandime për shumën 110,086,000 lekë të arkëtueshëm.*
- 3. Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës janë rekomanduar: 6 masa disiplinore nga “Vërejtje me paralajmërim” deri “Largim nga detyra”. Lidhur me zbatimin e tyre nuk ka informacion në ZVRPP Dibër, pasi kompetencën për dhënien e masave disiplinore e ka ZQRPP Tiranë.*

Rekomandim. Nisur nga fakti që Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Dibër është brenda afatit kohor të zbatimit të detyrave prej 6 muajve, të bëhet ndjekja sipas procedurave ligjore, të zbatimit të rekomandimeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Mars 2017

9. NË ZYRËN EREGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME DEVOLL

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 38 rekomandime gjithsej, nga këto: 37 masa organizative dhe 1 masë zhdëmtimi me vlerën 668,800 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- 4. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 36 masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 35 dhe nuk është pranuar një masë organizative.*
- 5. Për shpërblim dëmi është lënë 1 rekomandim për shumën 668,800 lekë të farkëtueshëm, i cili është pranuar.*
- 6. Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës janë rekomanduar: 3 masa disiplinore nga “Vërejtje me paralajmërim” deri “Largim nga detyra”. Lidhur me zbatimin e tyre nuk ka*

informacion në ZVRPP Devoll, pasi kompetencën për dhënien e masave disiplinore e ka ZQRPP Tiranë.

Rekomandim. Nisur nga fakti që Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Devoll është brenda afatit kohor të zbatimit të detyrave prej 6 muajve, të bëhet ndjekja sipas procedurave ligjore, të zbatimit të rekomandimeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Mars 2017

10. NË ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME TIRANË

Auditimi u krye në zbatim të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 1, dt. 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Programit të Auditimit nr. 1116, dt. 04.11.2016 dhe Njoftimit të Auditimit nr. 1116/1 dt. 04.11.201 me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm”.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë 96 rekomandime gjithsej, nga të cilat: 53 masa organizative, 12 masa zhëmtimi me vlerën 228,513,887 lekë, si dhe 31 masa disiplinore, nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” dhe për ata me kontratë, nga masa “Vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, (ndërsa për 41 ish-punonjësit e larguar dhe që nuk kanë adresim institucional, masa e rekomanduar do të ishte “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”).

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 53 masa organizative, nga të cilat, janë zbatuar plotësisht 26 , janë zbatuar pjesërisht 3 dhe nuk janë zbatuar 24 masa.

Për shpërbllim dëmi janë lënë 12 rekomandime për shumën 228,513,887 lekë të arkëtueshme, nga të cilat, janë zbatuar pjesërisht (vendosur kufizimi) 3 masa me vlerë 15,376 mijë lekë dhe nuk janë zbatuar 9 masa me vlerën 213,138 mijë lekë.

Për masat disiplinore, janë lënë 31 masa për punonjësit aktualë, nga të cilat janë zbatuar 23 masa disiplinore dhe nuk janë zbatuar masat për 8 punonjës.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, për të inventarizuar dhe çelur dosjet përkatëse për 2209 kërkesa për informacion, verifikim, konfirmim të Titujve të pronësisë së tokës bujqësore të KVVTP drejtuar ZVRPP duke kthyer shkresat origjinale në arkiv dhe për 1373 kërkesa ku nga ZVRPP Tiranë nuk janë kthyer përgjigje në shkelje të afateve ligjore, të zbatohen procedurat dhe të filloje pasqyrimi në KPP deri në zgjidhjen e plotë ligjore për regjistrimin e pasurive bujqësore, të kthimit të përgjigjeve duke pasqyruar ngjarjet në KPP, me synim parandalimin e transaksioneve, uljen e praktikave në proces me aplikime të papërfunduara, eliminimin e vonesave në regjistrim të Pasurive bujqësore, pasqyruar në “Tabela e përgjigjeve të kërkesave të KVVTP-ZVRPP për periudhën 2012- 6/muj I-rë 2015”, “Kërkesa, Projekt vendime dhe Vendime të KVVTP për ZVRPP për vitet 2012-6/mujori I-rë 2015”.

Brenda muajit Mars 2017

2. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, të inventarizohen dhe çelen dosjet përkatëse për 235 kërkesa për verifikim, konfirmim të Titujve të Pronësisë së Tokës bujqësore të ZVRPP drejtuar KVVTP, duke kthyer shkresat origjinale në arkiv, dhe për 197 kërkesa pa përgjigje, dërguar për shqyrtim në KVVTP, të rishqyrtohen AMTP-të nga ZVRPP Tiranë dhe për ato AMTP që dalin detyrim dhe kompetencë e ZVRPP pasi të identifikohen pasuritë, të zbatohen procedurat ligjore të regjistrimit me synim kryerjen e shërbimit të paguar dhe të pa marre të qytetarëve, pasqyruar sipas tabelave “Kërkesa të ZVRPP Tiranë drejtuar KVVTP për vitet 2012-6/mujori I-rë 2015”, “Personat përgjegjës për kërkesat pa përgjigje ndaj ZVRPP nga KVVTP dhe për përgjigje të vonuara 2012-2015”.

Brenda muajit Mars 2017

3.Rekomandimi:

ZVRPP Tiranë nuk ka një evidentim, ndjekje dhe informim të brendshëm të stafit të ZVRPP Tiranë, për pronat e regjistruara me mbivendosje, të cilat nga auditimi mundëm me afërsi të evidentojmë raste me disa pasuri të llojit tokë troje, objekte, të regjistruara me mbivendosje, kryesisht ndaj pronës shtetërore dhe ndaj pronave private, duke evidentuar një performancë të dobët menaxhimi, mungesë transparence, trajtim i pabarabartë i palëve, si pasojë në disa raste dhe krijimin e regjistrimeve me mbivendosje nga vetë kjo zyrë, në kundërshtim me ligjin nr. 7843 datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ligjin nr. 33/12, datë 21.03.2012 dhe me aktet tjera nënligjore

Brenda muajit Mars 2017

4. Rekomandimi:

ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë, të ndjekin hapat e duhura ligjore, për vendosjen dhe instalimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, lidhur me Sistemin e Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) dhe të hartojnë, miratojnë e zbatojnë dokumentet ligjorë:

a. Rregulloren e brendshme të Funkcionimit të Administratës së ZVRPP Tiranë, të miratuar nga Kryeregjistruesi të bazuar ne organikat dhe organigramat dërguar nga Kryeministri me urdhrat nr. 196, datë 4.8.2014 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Urdhrin nr. 33, datë 2.4.2013, të Kryeministrit”; ku të përfshijnë (shkruhen) kushtet e pranimit, testimit fillestar dhe në vazhdim të aftësive profesionale, trajnimit dhe aftësimit të marrjes në punë të punonjësve në këtë ZVRPP, statusi i të punësuarve si dhe përcaktim të kryerjes së detyrave, ushtrimin e kompetencave dhe mbajtjes së përgjegjësive të secilit specialist sipas 10 sektorëve, Regjistruesit, 2 zv. Regjistruesve dhe 3 juristëve, detyrimet lidhur me përgatitjen e evidencave, informacionit në tërësi administrimin e dokumentacionit, si dhe të përcaktohen e vendosen SMKB (Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm) nëpërmjet vënies nën administrim dhe administrimit të dokumentacionit tërësor dhe të praktikave në proces (mos lënia e tyre për kohë të gjatë tek specialistët).

b. Të hartojë Rregulloren Tekniko-Ligjore të përshtatur e përditësuar me ligjin e ri dhe bazën tjetër ligjore të re të ndryshuar, pasi Rregullorja tekniko-ligjore aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, përveç se është një rregullore tekniko ligjore e tejkaluar në kohë dhe me ndryshime të pjesshme, që nuk përshtaten me ligjin aktual.

Brenda muajit Mars 2017

5. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masat për inventarizimin e dokumentacionit, të kryejë kontrollin ligjor të rregullshmërisë së praktikave të mbetura në proces dhe të evadohen 15 533 aplikimet e praktikave,që aktualisht janë në proces, të analizohen dhe kthehen të ardhurat

e përfituara, pa dhënë shërbimin e faturuar në vlerën 55,269 mijë lekë, e cila ka sjellë mungesën e transparencës së punës së ZVRPP Tiranë ndaj publikut. Të inventarizohen, administrohen në arkiv dokumentacioni përkatës i praktikave, si dhe të evidentohen e inventarizohen praktikat në proces të vitit 2015, sipas tabelës analitike nr. 2 “Përmbledhëse e praktikave ne proces te pa përfunduara sipas viteve” dhe tabelës nr. 3 “Përmbledhëse e Praktikave të papërpunuara dhe në proces dhe të ardhurat e përfituara pa shërbim prej para Vitet 2010dhe 2011- 6/mujori 2015”.

Brenda muajit Mars 2017

6. Rekomandimi:

Të bëhet rilevimi i pasurive për rreth pasurisë mëmë nr. 3/22, v. 13, fq. 51, zk. 8210, duke identifikuar pasuritë, si dhe të bëhen shënimet në kartelën e pasurisë në përputhje me kërkesat ligjit 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Rregulloren Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 si dhe Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

Brenda muajit Mars 2017

7. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, për vlerësimin e ligjshmërisë së dokumentacionit të regjistrimit të legalizimit nr. 103911, datë 06.08.2013, për 12 kate banimi dhe 4 kate aktivitet për objektin Q T R C pasuria nr. 3/22, v. 13, fq. 51, zk. 8210, e cila është në kundërshtim me kondicionet e lejes së ndërtimit Nr. 91, datë 07.06.2008 si dhe ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” Neni 2-Fusha e Zbatimit, pika 4 dhe me planin urbanistik të qytetit të Tiranës i miratuar me Vendimin nr. 1, datë 15.02.2013 të KKT-së, duke bërë sistemimet e nevojshme.

Brenda muajit Mars 2017

11. Rekomandimi:

Nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, të nxirret urdhër kufizimi për pasuritë e ndodhura parcelën nr. 315 zona kadastrale 3866, Yzberisht, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor të kërkuar, sipas urdhrit për vendosjen e kufizimit nr. 474, datë 23.03.2011, të ish-Regjistruesit F. H.

Brenda muajit Mars 2017

17. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 59, për pasurinë nr. 74, me sipërfaqe prej 3000 m², truall, volum 7 faqe 78 zona kadastrale 1167, ky kufizim të zgjasë deri në ndryshimin e kontratës së qerasë nr. 1350/1802, datë 09.9.2013.

b. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa dhe t’i bëhet me dije Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, mbi konstatimin nga auditimi i KLSH-së për parregullsitë sipas kontratës nr. 1350/1802, datë 09.9.2013 dhe parregullsive në regjistrim me pasoja financiare në vlerën 7,200,000 lekë.

Brenda muajit Mars 2017

19. Rekomandimi i lënë:

Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa dhe të bëjë korrigjimin në kartelën e pasurisë 123/4 vol. 12, fq. 9, duke vendosur sipërfaqen e saktë, bazuar në Neni 63 “Korrigjimi nga regjistruesi” i ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” si dhe Udhëzimin metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

Brenda muajit Mars 2017

21. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP-Tiranë të marrë masa për ndarjen në sistem të dy referencave, si dhe numërtimi i tyre i ri për secilën nga pasuritë nr. 124/27, vol. 26, fq. 117, nr. 124/28, vol. 26,

fq. 118 zk. 2679 dhe njëra për pasuritë nr. 37/42+1-4, vol. 23, fq. 89 me sip 68.1 m2 dhe dhe nr. 37/42-G9, vol, 26 fq.45, me sip. 53.1 m2, zk. 2679.

Brenda muajit Mars 2017

22. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të identifikojë pasuritë objekt zona 1, të ndjekë procedurat për hartimin e dokumentacionit, regjistrimin, evidentimin e raportimin të ndjekjes së proceseve gjyqësore dhe zbatimit e pasqyrimin në KPP për periudhën 2012, 2013, 2014 dhe 2015 lidhur me 37 vendimet e Gjykatës së Shkallës Parë Administrative Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Tiranë për të cilat në 8 raste ZVRPP ka qenë pale kërkuese, ku gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVVTP, mbajtës të AMTP-ve sipas vendimeve që i përkasin Zonës 1, ZVRPP Tiranë të dërguara për regjistrim të pavlefshmërisë së plotë dhe të pjesshme dhe regjistrim “Shtet” të 30 AMTP-ve me mbi 45 pasuri me sipërfaqe totale prej 647 660 m2 për të cilat:

- a. -Të kërkojë kufizim, kthim e regjistrim në pronësi ”shtet” të sipërfaqes prej 332 881 m2 tokë bujqësore të llojit “arë”, ”vresht”, ”ullishtë” “pemëtoare”.
- b. Të vendosë masat kufizuese për pasuritë ku nuk është vendosur kufizim në sipërfaqen 332,881 m2, gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit,
- c. Të regjistrojë “Shtet” pasuritë (ku nuk është regjistruar “Shtet” asnjë metër) që i përkasin sipërfaqes 332 881 m2,
- d. Të vendoset kufizimi mbi dy pasuritë e tjetërsuara me sipërfaqe 9955 m2, me vlerën prej 13,174,135 lekë (në të dyja rastet ka përfunduar procesi gjyqësor vetëm në shkallë të parë me rrëzimin e padisë, ndërkohë që nga ZVRPP deri në marrjen e vendimit nga gjykata nuk është ndërmarrë asnjë veprim për kufizimin mbi këto pasuri), deri në përfundimin e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët.

Brenda muajit Mars 2017

23. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë të gjitha masat, duke ndjekur hapat e nevojshëm ligjor, për të kërkuar në mënyrë administrative dhe ligjore, kthimin e shumës 448,000 lekë, përfituar padrejhtësisht nga pronari në pronësi të H. Zh.

Brenda muajit Mars 2017

29. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa dhe të identifikojë pasuritë objekt Zona 2, të ndjekë procedurat për hartimin e dokumentacionit, regjistrimin, evidentimin e raportimin të ndjekjes së proceseve gjyqësore dhe zbatimit e pasqyrimin në KPP për periudhën 2012, 2013, 2014 dhe 2015 lidhur me 24 vendimet marrë nga Gjykata e Shkallës Pare Administrative Tirane, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Tiranë, ku gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVVTP, mbajtës të AMTP-ve sipas vendimeve që i përkasin Zonës 2, ZVRPP Tiranë të dërguara për regjistrim të pavlefshmërisë së plotë dhe të pjesshme dhe regjistrim “shtet” të 30 AMTP-ve me mbi 50 pasuri me sipërfaqe totale prej 342,780 m2 për të cilat:

- a. Të kërkojë shlyerje të detyrimit ndaj shtetit për sipërfaqen e tjetërsuar prej 15050 m2 ne vlerën 6,742,400 lekë, si dhe të vendosë barrë mbi to, deri në shlyerje dhe kufizim, kthim e regjistrim në pronësi ”shtet”, të sipërfaqes prej 327,730 m2 tokë bujqësore, të llojit “arë”, ”vresht”, ”ullishtë”, në përputhje me vendimet e gjykatës, pasi ato të kenë marrë formë të prerë.
- b. Të vendosë masat kufizuese, për pasuritë ku nuk është vendosur kufizim në sipërfaqen 327,730 m2, gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit, deri në përfundimin e plotë të procesit të shqyrtimit.

c. Të marrë masa për të siguruar regjistrimin “Shtet” pasuritë (ku nuk është regjistruar “Shtet” asnjë metër) që i përkasin sipërfaqes 327,730 m², në përputhje edhe me vendimet përfundimtare.

d. Të kërkojë nëpërmjet rrugës ligjore, arkëtimin e dëmit ekonomik sipas vlerës përkatëse të tregut, për sipërfaqen 20160 m², të kthyer në pronësi “Shtet “ sipas vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe vendimeve të KVVTP, që rezultojnë e shitur pas marrjes së këtyre vendimeve, kjo referuar edhe vendimeve përfundimtare të shqyrtimit.

Brenda muajit Mars 2017

36. Rekomandimi:

ZVRPP Tiranë Regjistruesi të vendosë masë kufizimi në seksionin përkatës të KPP-ve, pra të KPP “mëmë” nr. 4/83, v. 31, f. 124 zk. 8270 trull 1260 m², me 1401 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 640 m² e llojit pallat dhe në KPP nr. 8/743, v. 31 fq. 170, e llojit pallat trulli 1500 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 682 m², deri në llogaritjen dhe arkëtimin taksën e kalimit të pronësisë përkatësisht ndaj firmës “A ” shpk për sipërfaqen totale të përbashkët prej 795,4 m² në vlerën prej 795,400 lekë (795,4 m² x 1000 lekë/m²/ndërtim) dhe ndaj “D” shpk për sipërfaqen totale të përbashkët prej 1014,69 m² në vlerën prej 1,014,690 lekë (1014,69 m²x1000 lekë/m²/ndërtim),(vlera të cilat blerësit qytetar i kanë paguar në çmim të blerjes) deri në arkëtimin e vlerave të mësipërme nga firmat përkatëse ndërtuese, si dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës prej 45,990 lekë ndaj personave për kontrata shitje, shuma që përbëjnë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Brenda muajit Mars 2017

37. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të identifikojë pasuritë objekt në zonën 4, të ndjekë procedurat për hartimin e dokumentacionit, regjistrimin, evidentimin e raportimin të ndjekjes së proceseve gjyqësore për periudhën 2012, 2013, 2014 dhe 2015 dhe zbatimin e pasqyrimin në KPP lidhur me 16 vendimet e Gjykatës Shkallës Pare Administrative Tirane, Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Tiranë për të cilat në 12 raste, ZVRPP ka qenë palë kërkuese, ku gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVVTP, mbajtës të AMTP-ve, sipas vendimeve që i përkasin Zonës 4 të ZVRPP Tiranë të dërguara për regjistrim të pavlefshmërisë së plotë dhe të pjesshme dhe regjistrim “shtet” të 21 AMTP-ve me mbi 37 pasuri me sipërfaqe totale prej 152372 m² për të cilat:

a.-Të kërkojë shlyerje të detyrimit të shtetit në vlerën 5,479,500 lekë ndaj personave përkatës, për sipërfaqen e tjetërsuar prej 12740 m² dhe të vendosë kufizim, kthim e regjistrim në pronësi ”shtet” të sipërfaqes 146872 m², tokë bujqësore llojit “arë”, “vresht”, “ullishtë”.

b -Të vendosë masat kufizuese (pasi masë kufizimi është vendosur vetëm në 2 raste për sipërfaqen 16 010 m²), për pasuritë ku nuk është vendosur kufizim në sipërfaqen 124 362 m², gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit,

c.- Të regjistrojë “Shtet” pasuritë (ku nuk është regjistruar “Shtet” asnjë metër) që i përkasin sipërfaqes 140 373 m²,

d.-Të kërkojë dhe sigurojë shlyerjen e dëmit ekonomik për pasuritë e tjetërsuar në 2 raste për sipërfaqen 12 740 m² me vlerën prej 5,479,500 lekë, si dhe të vendosë barrë mbi to deri në shlyerjen e detyrimit vlerësuar nga gjykata, mosveprim që ka sjellë si pasojë mos arkëtim e detyrimit dhe që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit,

e. Të kërkojë nëpërmjet rrugës ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë përkatëse të tregut për sipërfaqen e shitur prej 3500 m² “Shet“ dhe të vlerës prej 21,045,000 lekë, sipas çmimit të realizuar të kontratës së shitjes për sipërfaqen 3000 m² pronë “Shtet”; (sipas konstatimit -është lejuar tjetërsimi e shitja e pronës shtet në 2 raste në sipërfaqen prej 6500 m²(sipërfaqe “shtet” kthyer nga gjykata), duke i shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën mbi 21,045,000 lekë sipas çmimit të realizuar të kontratës së shitjes

pasqyruar në tabelën. “ZVRPP Tiranë Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë v. 2012-2015 zona nr. 4”.

Brenda muajit Mars 2017

38. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, të marrë masa për pjesëmarrjen në seancat gjyqësore, të shqyrtojë, analizojë dhe të zbatojë procedurat, hartojë dokumentacionin për regjistrimin, identifikimin e pasurive objekt gjykimi, kryejë evidentimin e raportimin të ndjekjes së proceseve gjyqësore dhe të bëjë pasqyrimin në KPP për vendimet e gjykatës e të KVVTP të vitit 2012, 2013, 2014 dhe 2015, ku ZVRPP Tiranë si palë e tretë apo e paditur gjithnjë ka qenë në mungesë, pasqyruar në tabelën “ZVRPP Tiranë Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë v.2012-2015 ZONA nr. 4”

Brenda muajit Mars 2017

39. Rekomandimi:

ZVRPP Tiranë, Regjistruesi të marrë masa, me urdhër të veçantë të bëjë rregullimet e duhura ligjore dhe regjistrimet e sakta në KPP-të e pasurive nr. 8/409 v. 24, f. 55, zk. 8330 truall me sip. 1817 m², dhe mbi pasurinë nr. 8/410 v. 24, f. 56, zk. 8330 truall me sip. 1817 m², dhe të zbatojë procedurat ligjore të mbivendosjes, duke respektuar refuzimin e regjistrimit për pjesën e mbivendosur, për atë pjesë (sikundër është lëshuar certifikata datë 21.7.2014 si dhe të bëjë orientimin njoftimin e palëve për zgjidhjen e çështjes në rrugë administrative a gjyqësore; duke dëshmuar parregullsitë e punonjësit lidhur me aplikimin nr. 52750, datë 03.10.2014 dhe parregullsinë e KPP-ve.

Brenda muajit Mars 2017

45. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Tirana të marrë masa, që në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor dhe saktësimin të regjistrimeve, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 3/659, volum, 8 faqe 85, me sipërfaqe trualli prej 875 m² dhe objekti s`ka m², të ndodhur në zonën kadastrave nr. 8230.

Brenda muajit Mars 2017

48. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor dhe zgjidhjen e marrëdhënies së pronësisë mbi truallin, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë “Godinë banimi dhe shërbime 10 kat me 1 kat parkim nëntokë” të miratuar me Vendim KRRT-je nr. 37/3,4, datë 21.07.2001 dhe nr. 219, datë 26.04.2005”, ndërtuar e investuar nga “A K shpk”, të ndodhura në zonën kadastrave nr. 8230.

Brenda muajit Mars 2017

49. Rekomandimi: Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, për arkivimin e referencave të punuara e të pa dorëzuara nga specialistët, në arkivin e institucionit.

Brenda muajit Mars 2017

50. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të evidentojë të gjitha pasuritë për të cilat KLSH ka rekomanduar masa kufizuese por që ende rezultojnë të pa kufizuara, si dhe për të gjitha rastet e tjera të heqjes së kufizimeve nga vet ZVRPP, pa pasur një ngjarje ligjore për të përligjur procedurat, të veprojnë sipas referencave të mësipërme. Evidentimi i rasteve të moszbatimit apo tjetërsimit të rekomandimeve të KLSH ti referohet procesverbalit nr. 33, datë 20.11.2015.

Brenda muajit Mars 2017

52. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Tiranë për të gjitha rastet e kufizimeve të mëparshme të rekomanduara nga KLSH, të mos veprojë referuar në shkresën e ZQRPP nr. 6697/1, datë 10.07.2014, por të procedojë vetëm në bazë të dokumentacionit ligjor, si vendimeve gjyqësore të formës së prerë, rekomandimeve të KLSH apo vendimeve të lëshuara nga organet të cilat kanë për kompetencë ligjore trajtimin e rasteve, procedurë në zbatim të nenit 59 dhe 75 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

Brenda muajit Mars 2017

53. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Tirana për të gjitha rastet e KPP të paplotësuara, pra boshe, të cilave u ka kaluar numri, të nxjerrë urdhër për anulimin e tyre dhe të vendos shënimin përkatës në secilën KPP, procedurë kjo në zbatim të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

Brenda muajit Mars 2017

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.Rekomandimi:

Nga ZVRPP Tiranë të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej 27,500 lekë e shkaktuar nga vonesa në regjistrim prej 100 ditësh kontratës së shitjes nr. 11296 rep, nr. 3527 kol, në datë 12.11.2010, sipas Ref nr. 6990, ndërmjet shoqërisë “A. H. K.” Sh.p.k në cilësinë e shitësit dhe V.N., Y.B., A.H. në cilësinë e blerësve, për sipërfaqen e truallit 5920 m2, pasurisë nr. 3/22, v. 13, fq. 51, zk. 8210, në zbatim të nenit 39 “Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim” i ligjit 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Brenda muajit Mars 2017

2. Rekomandimi:

Nga ZVRPP Tiranë, të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej 3,900,730 lekë e shkaktuar nga mos llogaritja dhe ndalesa e taksës së kalimit të pronësisë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme neni 50, “Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa”, pika 2, ligjin nr. 9632, datë 30.10.1996 “Për Sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar neni 28, pika 2, ndaj investitorëve përkatësisht si më poshtë:

- a- “N 10” Sh.p.k – vlera 453,800 lekë(sip. 435,8 m2 x 1000 lekë/m2)
- b- “A N” Sh.p.k - vlera 575,320 lekë (575.32m2x1000 lekë/m2)
- c- “T” Sh.p.k.- vlera 2,135,510 lekë (sip.2135.51 m2 x1000 lekë/m2)
- d- “M. K.” Sh.p.k- vlera 754,100 lekë (sip.754.10 m2 x 1000 lekë/m2).

Brenda muajit Mars 2017

3.Rekomandimi:

Nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, të vihet në dijeni Bashkia Tiranë për shkeljet e konstatuara, e cila duhet të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej 170,007,707 lekë e shkaktuar nga shmangia nga tarifa e marrjes së lejes ndërtimit duke kaluar në procedura legalizimi, në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, neni 51, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, pasi nuk kemi të bëjmë me ndërtim informal, por është ndërtim i ligjshëm dhe procedurat duhet të kryheshin sipas lejes ndërtimit me Bashkinë Tiranë, sepse nuk ka shtesa të paligjshme.

Brenda muajit Mars 2017

4. Rekomandimi:

Nga ZVRPP Tiranë, të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej 920,250 lekë e shkaktuar nga shmangia e pagesës për tarifatat dhe taksat e shërbimit për regjistrimin fillestarë të njësisve në kundërshtim me ligjin 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, përkatësisht si më poshtë:

- “M. K.”- vlera 884,000 lekë,
- “N10” Sh.p.k – vlera 36,250 lekë.

Brenda muajit Mars 2017

5. Rekomandimi:

ZVRPP Tiranë, Regjistruesi të kërkojë nëpërmjet rrugës ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë 9,430,020 lekë sipas çmimit të realizuar të kontratës së shitjes për sipërfaqen 21,300 m² “Shtet”; (sipas konstatimit është lejuar tjetërsimi e shitja e pronës shtet në 7 raste në sipërfaqen prej 21,300 m²(e kthyer “shtet” në 5 raste nga gjykata dhe në 2 raste me vendim të KVTTP-së, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit dëmin ekonomik në vlerën prej 9,430,020 lekë), pasqyruar në tabelën nr. “ZVRPP Tiranë Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë v. 2012-2015 ZONA nr. 1”(bashkëlidhur këtij Raporti).

Brenda muajit Mars 2017

8. Rekomandimi:

ZVRPP Tiranë të marrë masa, të kërkojë shlyerje të detyrimit ndaj shtetit për sipërfaqen e tjetërsuar prej 41 m² në vlerën 1,071,617 lekë, si dhe të vendosë barrë mbi pasuritë 6/136, vol. 4, faqe 146, pas. Nr. 7/155, vol. 11, faqe 64, dhe Pasuria nr. 7/156, vol. 11, faqe 66 , deri në shlyerje, ZK 8330, deri në shlyerjen e detyrimit dhe zgjidhjen e problemit të mbivendosjes.

Brenda muajit Mars 2017

9. Rekomandimi:

Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës 4,306,000 lekë, për subjektet ndërtuese “A K” shpk, “A” shpk dhe “W” shpk .

Brenda muajit Mars 2017

10. Rekomandimi:a. Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës 300,000 lekë prej zotit S.N.

Brenda muajit Mars 2016

b. ZVRPP Tiranë Regjistruesi, pasi të vendosë masë kufizimi në seksionin përkatës të KPP-ve, pra të KPP “mëmë” nr. 4/83, v. 31, f. 124 zk. 8270 truall 1260 m², me 1401 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 640 m² e llojit pallat dhe në KPP nr. 8/743, v. 31 fq. 170, e llojit pallat truall 1500 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 682 m², të kërkojë arkëtimin e vlerës 1,856,080 lekë, përkatësisht: ndaj firmës “A 01” shpk për sipërfaqen totale të përbashkët prej 795,4 m² në vlerën prej 795,400 lekë (795,4 m² x 1000 lekë/m²/ndërtim) dhe ndaj “D” shpk për sipërfaqen totale të përbashkët 1014,69 m² në vlerën prej 1,014,690 lekë (1014,69 m² x 1000 lekë/m²/ndërtim), si taksë e kalimit të pronësisë e pa llogaritur dhe e pa arkëtuar në momentin e regjistrimit të pallatit (vlera të cilat blerësit qytetar i kanë paguar në çmim të

blerjes së apartamenteve, garazheve) dhe të vlerës prej 45,990 lekë ndaj personave për kontrata shitje.

Brenda muajit Mars 2017

c. ZVRPP Tiranë, Regjistruesi të identifikojë pasuritë objekt zona 4, të zbatojë 16 vendimet e Gjykatës Shkallës së Parë Administrative Tiran, Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Tiranë ku në 12 raste ZVRPP ka qenë palë kërkuese, për të cilat gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVVTP, mbajtës të AMTP-ve sipas vendimeve që i përkasin Zonës 4, pagimin e detyrimeve prej të cilave:

1.-Të kërkojë dhe sigurojë shlyerjen e detyrimit në vlerën prej 5,479,500 lekë që i përket pasurive “Shtet” të tjetërsuara gjatë procesit të gjykimit në 2 raste për sipërfaqen 12 740 m2 pasi të ketë vendosë barrë mbi to deri në shlyerjen e detyrimit vlerësuar nga gjykata, sipas tabelës.“ZVRPP Tiranë Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë v. 2012-2015 zona nr. 4”.

2. Të kërkojë nëpërmjet rrugës ligjore arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë përkatëse të tregut për sipërfaqen e shitur prej 3500 m2 “Shtet“ dhe të vlerës prej 21,045,000 lekë sipas çmimit të realizuar të kontratës së shitjes për sipërfaqen 3000 m2 pronë “Shtet”; që i përket pasurive “Shtet” të tjetërsuara gjatë procesit të gjykimit (sipas konstatimit -është lejuar tjetërsimi e shitja e pronës shtet ne 2 raste në sipërfaqen prej 6500 m2(sipërfaqe “shtet” kthyer nga gjykata), duke i shkaktuar buxhetit të shtetit dëmin ekonomik në vlerën mbi 21,045,000 lekë sipas çmimit të realizuar të kontratës së shitjes) pasqyruar në tabelën.“ZVRPP Tiranë Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë v. 2012-2015 zona nr. 4”.

Brenda muajit Mars 2017

11. Rekomandimi:

Nga ZVRPP Tiranë të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej 300,000 lekë e shkaktuar nga mos aplikimi i penaliteteve për vonesa në regjistrim për pasurinë nr. 3/320/ND, volum, 29 faqe 3, të ndodhur në zonën kadastrave nr. 8230, veprime në kundërshtim me nenin 39 “Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim”, të ligjit 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Brenda muajit Mars 2017

12. Rekomandimi:Nga ZVRPP Tiranë të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej 170,500 lekë e shkaktuar nga mos aplikimi i penaliteteve për vonesa në regjistrim për pasurinë nr. 3/67-ND, volum, 28 faqe 138, të ndodhur në zonën kadastrave nr. 8230, veprime në kundërshtim me nenin 39 “Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim”, të ligjit 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Brenda muajit Mars 2017

C. MASA DISIPLINORE

Për masat disiplinore, janë lënë 31 masa për punonjësit aktualë, nga të cilat janë zbatuar 23 masa disiplinore, duke mos zbatuar masat për 8 punonjës. Rekomandimi i është lënë për zbatim ZQRPP Tiranë.

Rekomandojmë ndjekjen dhe për 9 punonjësit, si më poshtë:

1. Për znj. L.B., me detyrë **Regjistruesi** prej 15.12.2014 e vazhdim.
2. Për z. F.I., me detyrë **zv. Regjistruesi**, prej 22.10.2013.
3. Për z. D.S., me detyrë **zv. Regjistruesi**, prej 13.5.2013 e vazhdim.
4. Për z. R.B., me detyrë përgjegjës i zonës 4, prej datës 21.4.2015.
5. Për znj. R.P., me detyrë specialiste juriste.
6. Për z. S.H., me detyrë ish-hartograf, zona 4, aktualisht specialist në SMP.
7. Për znj. G.H., me detyrë Specialiste/Juriste e Zonës 5.
8. Për znj. E.P., me detyrë Specialiste/Juriste e Zonës 5.

11 . DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT DURRËS:

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Mjedist Durrës, për zbatimin e rekomandimeve, të KLSH-së. “Mbi zbatimin e rregullshmërisë ekonomiko-financiare” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe sipas Vendimit nr.24 datë 30.03.2016 të Kryetarit të KLSH-së është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr. 1208/1, dt 05.01.2015.

Nga ana e subjektit është kthyer përgjigja me shkresën përcjellëse nr. 477/1 dt. 22.04.2016, me programin e punës për zbatimin e rekomandimeve, bazuar në urdhrin e brendshëm të titullarit nr. 10, datë 06.04.2016 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH sipas raportit përfundimtar”, në të cilin janë përcaktuar personat përgjegjës dhe afatet për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria Rajonale e Mjedisit Durrës, **nuk** ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve të KLSH.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 28 rekomandime gjithsej, nga të cilat:

- a) Janë rekomanduar 20 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 20 rekomandime, janë zbatuar 18 dhe 2 pa zbatuar
- b) Është rekomanduar 1 masë shpërblim demi me vlerën 1,409,000 lekë, zbatuar pjesërisht, arkëtuar 409 mijë lekë dhe në proces diferenca prej 1,000 lekë.
- c) Janë rekomanduar 7 masa disiplinore, janë pranuar 7 dhe zbatuar 1 masë.

Në përfundim rikërkojmë nga DRM Durrës, përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 477/1 dt. 22.04.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara.

A . MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 3.

DRM Qarku Durrës, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, të evidentojë subjektet, veprimtaria e të cilave shkaktojnë ndotje të ujërave mbi normat e lejuara si dhe të përcaktojë në kushtet e lejes së mjedisit të tipit C, mjedisin pritës ku do të derdhen ujërat e pastruara dhe regjimin e derdhjes së tyre (depuratorët e pastrimit përkatës), kërkesat për trajtimin mjedisor të llumrave, që rezultojnë nga trajtimi i ujërave të ndotura, në përputhje me natyrën, përbërjen dhe sasinë e tyre, mbajtjen e regjistrave si dhe kryerjen e monitorimit dhe publikimin e rezultateve të tij.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 5.

DRM Qarkut Durrës të marrë masa për saktësimin e adresave dhe të njoftojë 672 subjektet nga të cilët: 4 subjekte me Leje Mjedisi të tipit A, 11 subjekte me Leje Mjedisi të tipit B dhe 657 subjekte me Leje Mjedisi të Tipit C, të cilët nuk kanë bërë pagesën e tarifës vjetore sipas kërkesave ligjore të përcaktuara dhe në kushtet e Lejeve të Mjedisit.

DRM Qarku Durrës të marrë masa që subjektet të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë Qark dhe që janë të pajisur me Leje Mjedisi të Tipit (A, B dhe C) të paguajnë tarifën vjetore brenda 3-mujorit të parë të vitit.

Brenda muajit Mars 2017

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandimi 1.

DRM Qarkut Durrës, të marrë masa në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve për kërkimin e arkëtimit të tarifës vjetore që rezulton e pa paguar nga 487 subjekte në shumën **1,000,000 lekë** si më poshtë:

- 3 subjekte që disponojnë lejen e mjedisit të tipit A në vlerën totale 30,000 lekë
- 485 subjekte, që disponojnë lejen e mjedisit të tipit C në vlerën totale 970,000 lekë.

Brenda muajit Mars 2017

C. MASA DISIPLINORE

C I. Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, nenit 57, nenit 59 të ligjit, gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikes në administratën publike”, **i rekomandojmë Titullarit direkt të fillojë menjëherë** procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje”, sipas nenit 58, germa a të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” për:

- a. znj. S.V.
- b. znj. B.C.
- c. znj. E.Z.
- d. znj. M.S.
- e. z. E.V.
- f. znj. A.B.

Brenda muajit Mars 2017

12. DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT TIRANË

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, për zbatimin e rekomandimeve, të KLSH-së, ‘Mbi zbatimin e rregullshmërisë ekonomiko-financiare’ trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe sipas Vendimin nr.114 datë 23.09.2016 të Kryetarit të KLSH-së është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr. 685/1 datë 24.06.2016.

Nga ana e subjektit është kthyer përgjigja, me njoftim për hartimin e programit të punës nr. 2669/1 dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH.

Është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr. 685/1 datë 24.06.2016.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, DRM nuk ka kthyer përgjigje brenda 6-mujorit pasi është brenda afateve .

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse nr. 685/9 date 23.09.2016 janë lënë 28 rekomandime gjithsej, nga këto:

- a. Janë rekomanduar 28 masa organizative te cilat janë pranuar nga subjekti, nga të cilat 16 janë ne proces, 11 masa janë realizuar , 1 masë e pa realizuar.
- b. Është rekomanduar 1 masë shpërblim dëmi e cila është në proces, me vlerën 2,066,000 lekë.
- c. Janë rekomanduar 12 masa disiplinore, të pranuar plotësisht.

-Në përfundim rikërkojmë nga Drejtoria Rajonale të Mjedist Tiranë (DRM) përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 807/9 datë 31.12.2015, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, si më poshtë:.

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 27.

Drejtoria Rajonale e Mjedisit të planifikoje dhe të caktojë grup pune mbi zbatimin detyrat të lëna nga auditimi i mëparshëm dërguar me shkresën me nr. 835/2 prot, datë 04.07.2014 dhe të informoje zbatimin e tyre në KLSH sipas ligjit.

Brenda muajit Mars 2017

B. MASA SHPËRBLIM DEMI

DRM, Tiranë në bashkëpunim me ISHM Qendrore, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 2.066.000 lekë (1033 subjekte x 2,000 lekë), ndaj subjekteve debitorë, të cilët kanë kaluar të gjitha afatet ligjore dhe nuk kanë derdhur tarifën vjetore pranë DRM.

Brenda muajit Mars 2017

13. INSPEKTORIATI SHTETËROR I MJEDIST DHE PYJEVE FIER

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit dhe Pyjeve Fier, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “Mbi zbatimin e rregullshmërisë ekonomiko-financiare”, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe me Vendimin nr.183 datë 31.12.2015, të Kryetarit të KLSH-së është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr. 807/1 dat 10.0.2015.

Nga ana e subjektit është përgatit, me shkresa me nr. 477/1 datë, 22.04.2016, me programin e punës për zbatimin e rekomandimeve, bazuar në urdhrin e brendshëm të titullarit “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, sipas raportit përfundimtar”, në të cilin janë përcaktuar personat përgjegjës dhe afatet për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria Rajonale Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve Fier, **nuk** ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve të KLSH.

Nga ana e KLSH-së me shkresat përcjellëse janë lënë 48 rekomandime gjithsej, nga të cilat:

a- Janë rekomanduar 25 masa organizative.

b- Janë rekomanduar 4 masa shpërblim demii, në vlerë 750 mijë lekë, nga të cilat janë zbatuar 2 rekomandime në vlerën 340 mijë lekë dhe janë në proces dy rekomandime në vlerë 410 mijë lekë.

c- Janë rekomanduar 14 masa disiplinore të lëna për ISHMP

d- Janë rekomanduar 5 masa disiplinore Kryeinspektorit të Përgjithshëm, për tu marrë masa ndaj punonjësve të ISHMP.

- Në përfundim rikërkojmë nga Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve Fier (ISHMP) përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën

nr. 807/9 datë 31.12.2015, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 20.

Kryeinspektori i DR ISHMP Fier në bashkëpunim me juristin e Institucionit dhe strukturat përkatëse në ISHMP, të marrë masa për përcaktimin dhe ndjekjen e mënyrave efikase të shkëmbimit të informacionit me ISHMP dhe rritjen e bashkëpunimit kryesisht me Komisionin e Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative pranë ISHMP, mbi subjektet që kanë ankimuar brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për gjobën, me synim respektimin e afateve ligjore për ndjekjen në rrugë gjyqësore të proceseve administrative për nxjerrjen e urdhrat ekzekutiv të gjobave.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 21.

Kryeinspektori i DR ISHMP Fier në bashkëpunim me zyrën juridike, të marrë masa për të mos lejuar mungesa dhe mangësi dokumentacioni dhe provash në praktikat administrative, të cilat i përcillen gjykatës për nxjerrjen e urdhrave ekzekutiv, si dhe të ndjekë në vazhdimësi proceset gjyqësore, me qëllim ndjekjen deri në fund të zbatimit të akteve administrative, që kanë të bëjnë me gjoba, dhe vjeljen e tyre brenda afateve të përcaktuara.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 22.

DR-ISHMP Fier të marrë masa që dhe në bashkëpunim me institucione të tjera (DR Tatimeve Fier, DRM) të krijojë një bazë të dhënash efektive, ku të hidhen në mënyrë të vazhdueshme informacioni i përditësuar dhe që shërben për të përcaktuar planin e inspektimeve mbi bazë risku.

Brenda muajit Mars 2017

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandimi 1.

Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e shumës së dëmit ekonomik **prej 60,220 lekë në total si rezultat i përfitimit të karburantit nga kilometrat e vendosura me tepër krahasuar me kilometrat e përcaktuara të distancave të miratuara dhe në fuqi, si më poshtë vijon:**

-Shuma në **vlerën 28,206 lekë** nga z. J.G. me detyre shofer .

-Shuma në **vlerën 18,792 lekë** nga përfituesi z. K.Ll. me detyrë inspektor, përdorues mjeti.

-Shuma në **vlerën 13,222 lekë** nga përfituesi z. A.V. me detyrë inspektor, përdorues mjeti.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 2.

Të kontabilizohen dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e shumave **në vlerën 350,600 lekë** nga 6 punonjës (sipas listës bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit), vlerë e materialeve të përdorura jo konform procedurave dhe normativave. Kjo shumë ka rezultuar si diferencë midis faktit të bojës së harxhuar prej 130 copë çift bojërash (boje e zezë + tri kolor) për periudhë Dhjetor 2014 deri më 31.08.2015 për 4 printera dhe normatives së përdorimit të bojës së printerëve mbështetur dhe në normën e punës së mundshme të printerëve për periudhën e përdorimit në institucionin.

Brenda muajit Mars 2017

D. MASA DISIPLINORE

Për Kompetencë të ISHMP Tiranë

C1. Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, nenit 57 si dhe nenit 59 të ligjit , gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, mbështetur dhe në ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 të ligjit “ Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, do të kërkonim të fillonin procedurat për dhënien e masës disiplinore:

-Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga detyra” në bazë të analizës për rezultatet e auditimit të paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit në DRISHMP Fier për:

a. z. A.B. me detyrë **Kryeinspektor i DR-ISHMP Fier**

C2. Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, nenit 57 si dhe nenit 59 të ligjit , gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, do të kërkonim të fillonin procedurat për dhënien e masës disiplinore:

-“Mbajtja 1/3 e pagës së plotë për një periudhë tre mujore” neni 58, germa b, për:

Z. B.P., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Mjedisit.

C3. Për inspektorët e Sektorit të Ujërave pranë DR ISHMP Fier, të cilët kanë kaluar gjatë vitit 2015 në vartësi të Ministrisë të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në ABU Fier, i lihet në kompetencë të ISHMP t’i përcjellë masat disiplinore të përcaktuara, referuar konstatimeve në Raportin Përfundimtar të Auditimit të DR ISHMP Fier, “Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave” si më poshtë:

-“Mbajtja 1/3 e pagës së plotë për një periudhë tre mujore” neni 58, germa b, për:

a. Z. L. Ll., me detyrë, përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Ujërave.

-“Vërejtje” neni 58 , germa a, për:

b. Z. K.Ll., me detyrë inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ujërave.

c. Z. V.D., me detyrë inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ujërave.

14. AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorine Rajonale të Mjedist dhe Pyjeve Fier, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “Mbi zbatimin e rregullshmërisë ekonomiko-financiare” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe me Vendimin nr. 43, datë 30.04.2016 të Kryetarit të KLSH-së është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr. 1205/1, datë.05.01.2015.

Nga drejtori i AKZM është hartuar programi i punës me nr. 430 dt. 27.5.2016 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH sipas raportit përfundimtar nr. 1205/7 dt. 06.05.2016.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (AKZM), ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve të KLSH, sipas shkresës nr. 572, datë 02.06.2016.

Gjithesj janë lënë **4** rekomandime gjithsej, nga këto: 36 masa organizative, **4** masë zhdëmtimi me vlerën 9.224.148 lekë dhe 4 masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a- Janë rekomanduar 36 masa organizative te pranuar nga subjekti, nga të cilat 7 janë ne proces, 26 masa realizuar dhe 3 masa te realizuara pjesërisht.
- b- Janë rekomanduar 4 masa shpërblim demi me vlerë 9,224,148 lekë, nga të cilat janë pranuar 4 dhe janë arkëtuar nga 2 masa të realizuara pjesërisht 6,129 mijë lekë dhe kanë mbetur për t'u arkëtuar 3,095 mijë lekë.
- c- Janë rekomanduar 4 masa disiplinore për të cilat nuk ka informacion për zbatimin e tyre.

Në përfundim **rikërkojmë** nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1205/6 dt 30.04.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 1.

AKZM duhet në mënyrë të menjëhershme të përfundojë procesin e dorëzimit dhe të identifikimit të kontratave në ZM. Ajo duhet të përcaktojë qartë një sistem menaxhimi për ZM, të cilit t'i përmbahet me rigorozitet, sipas radhës: Identifikimi, Planifikimi, Menaxhimi, Monitorimi dhe Raportimi. Kjo radhë, të shoqërohet me plane strategjike dhe përcaktim të qartë objektivash për ti kthyer këto zona në statusin e dikurshëm. Gjithashtu, të merren masa që AKZM të planifikojë një hartë rrisht, e cila të përmbajë listën e Zonave më të rrezikuara.

Brenda muajt Mars 2017

Remandimi 24.

Nga AKZM të merren të gjitha masat organizative dhe financiare për hartimin e planeve të menaxhimit për të gjithë zonat e mbrojtura. Pjesë e rëndësishme e programit të AKZM duhet të jenë edhe:

- i. Rishikimi i ligjit për Zonat e Mbrojtura dhe i akteve nënligjore, nën fokusin e zhvillimeve të reja dhe të vizionit të IUCN-së.
- ii. Rishikimi i planeve të menaxhimit, jo vetëm i atyre që u ka kaluar afati, por veçanërisht planet që janë hartuar gjatë viteve 2010-2014, duke saktësuar përgjegjësitë e miratimit dhe të përdoruesve të tyre.
- iii. Rishikimi i përbërjes së Komiteteve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura, duke caktuar përgjegjësitë e anëtarëve të këtij komiteti, të cilët të kenë një rol më aktiv dhe jo vetëm konsultativ.
- iv. Sigurimin e plotë të përafrimit dhe zbatimit të dy direktivave bazë të BE-së: Të Habitatit dhe të Shpendëve, si dhe zhvillimin e Rrjetit Natyra 2000.

Brenda muajt Mars 2017

Rekomandimi 25.

Prioritet i programit të AKMZ-së, duhet të mbetet analiza e mangësive në sistemin e Zonave të Mbrojtura në nivel kombëtar, bazuar edhe në kërkesat për sisteme përfaqësues të zonave të mbrojtura. Në programet e saj AKZM dhe strukturat e varësisë, duhet të parashikojë e të zbatojë një sërë mekanizmash ligjorë, financiarë dhe institucionalë për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit. Këto mekanizma duhen orientuar sipas parimeve që burojnë nga konventat ndërkombëtare në fushën e natyrës dhe të biodiversitetit, të pasqyruara edhe tek Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin dhe Zonat e Mbrojtura, Plani Kombëtar të Integritimit në Evropë, si dhe në Programin e Qeverisë.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandimi 1.

Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen *arkëtimet në vlerën 14,645 lekë* nga subjekti "K" shpk, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 2: Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen *arkëtimi i shumave 6,602 lekë* nga subjekti "O" shpk, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit, *(trajtuar në faqet 58-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 3.

Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen arkëtimi i shumave *në vlerën 204,000 lekë* nga 30 punonjësit, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit. *(Të vazhdojë arkëtimi për shumën e mbetur prej 116 mijë lekë).*

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi 4.

Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të arkëtohen shumat *në vlerën 8,998,000 lekë* nga subjektet përkatëse, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit. *(Të vazhdojë arkëtimi për shumën e mbetur prej 2,957 mijë lekë).*

Brenda muajit Mars 2017

15 . AGJENCINA E BASENIT UJOR ISHËM ERZEN TIRANË

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Basenit Ujor Ishem-Erzen, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së "Mbi zbatimin e rregullshmërisë ekonomiko-financiare" trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe me Vendimin nr. 66, datë 27.06.2016 të Kryetarit të KLSH-së, është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr. 476/1, datë 26.04.2016.

Nga ana e subjektit është pregatit urdhri për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Agjencia e Basenit Ujor Ishem-Erzen, **nuk** ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve të KLSH.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar 13 masa organizative, janë pranuar 13, nga të cilat janë realizuar 5 masa dhe janë në proces 8 masa.

Në përfundim rikërkojmë nga Agjencia e Basenit Ujor Ishem -Erzen (ABU) përshejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1208/5, dt. 31.03.2016, mbi auditimin me objekt "Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë"

ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 2.

Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen, në bashkëpunim me strukturat e tjera përgjegjëse, të marrin masa për të hartuar dhe miratuar Projekt planin e Menaxhimit të Basenit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Ujit.

Në vazhdimësi

Rekomandimi 3.

Agjencia e Basenit Ujor Ishëm-Erzen në bashkëpunim me Drejtorinë e Politikave të Burimeve Ujore në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të marrë masa, duke vënë në dijeni strukturat qendrore të menaxhimit të ujërave për gjendjen në të cilën ndodhet Baseni Ujor Ishëm-Erzen, me qëllim që të sigurohet një funksionim normal i KBU Ishëm-Erzen, për të bërë të mundur zhblokimin e miratimit të lejeve dhe të mundësohet një nxitje e vazhdueshme e përdoruesve të ujit.

Në vazhdimësi

Rekomandimi.4. ABU Ishëm-Erzen të rrisë bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Mjedisit dhe struktura të tjera përkatëse dhe të marrë masa për të *hartuar dhe miratuar programe pune të përbashkëta*, për të bërë të mundur mbrojtjen e mjedisit dhe shmangien nga ndotjet të burimeve ujore.

Në vazhdimësi

Rekomandimi 6.

Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe KBU Ishëm Erzen në bashkëpunim me ABU Ishëm Erzen, të marrin masa dhe të ndjekin të gjitha hapat ligjorë, për të bërë të mundur realizimin e lidhjes së kontratave me subjektet sh.a Ujësjetllës kanalizime Kamëz, sh.a Ujësjetllës kanalizime Krujë dhe sh.a Ujësjetllës kanalizime Fushë-Krujë, të evidentuar si përdorues të ujit.

Në vazhdimësi

Rekomandimi 7.

ABU Ishëm Erzen në bashkëpunim me Drejtorinë e Politikave të Burimeve Ujore, në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të marrë masa për të përgatitur dokumentacionin tekniko ligjor për të gjithë subjektet, që kanë aplikuar për tu pajisur me leje, duke e dërguar për shqyrtim në mbledhjen më të afërt që do të zhvillojë KBU Ishëm Erzen, pas konstituimit të saj, për të marrë vendimet përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore.

Në vazhdimësi

Rekomandim 8.

ABU Ishëm Erzen në bashkëpunim me Drejtorinë e Politikave të Burimeve Ujore në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të marrë masa, duke ngritur grup pune që të ketë në përbërje specialistë të fushës, për të argumentuar teknikisht mundësinë ose pamundësinë e instalimit të matësve të ujit, në të gjitha burimet ujore që pretendohet pamundësia teknike e instalimit të tyre dhe bazuar në relacionin teknik të paraqitur, të veprohet dhe të realizohet instalimi i matësve të ujit nga subjektet sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Durrës dhe sh.a.Ujësjetllës Kanalizime Kavajë, për të shmangur abuzimet gjatë përdorimit të ujit.

Rekomandimi 9.

ABU Ishëm Erzen në bashkëpunim me Drejtorinë e Politikave të Burimeve Ujore në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të marrë masa dhe të kërkojë që subjektet e pajisura me leje për përdorimin e ujit, përpara se të instalojnë matësin e ujit, të paraqesin tek Agjencia e Basenit dokumentacionin tekniko ligjor, që vërteton se matësi ka kaluar procedurën e kolaudimit dhe përmbush kushtet teknike për tu vënë në përdorim. Në të kundërt të kërkohej pezullimi i lejes që disponon subjekti përkatës.

Në vazhdimësi

Rekomandim10.

Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në bashkëpunim me ABU Ishëm Erzen, të marrë masa për të hartuar dhe miratuar dokumente standarde, për të pasqyruar të dhënat kryesore dhe rezultatet e kontrollit e monitorimit të subjekteve, përfshirë të dhënat që përmban leja e përdorimit që disponon subjekti, si dhe referencën ligjore mbi të cilën mbahet akti.

Në vazhdimësi

16. ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ZVRPP) Berat”.

Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse janë lënë 63 rekomandime gjithsej, nga këto: 60 masa organizative dhe **3 masë** zhdëmtimi me vlerën **2,053,760 lekë**.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

d. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 60 masa organizative, të cilat, janë pranuar, zbatuar plotësisht 59, dhe është në proces zbatimi 1.

e. Për shpërblim dëmi janë lënë 3 rekomandime për shumën 2,053,760 lekë të arkëtueshëm të cilat, janë pranuar, dhe janë në proces zbatimi 3 rekomandime në vlerën 2,053,760 lekë, nuk është arkëtuar asnjë prej shumave të mësipërme.

f. Masa disiplinore janë kërkuar 14 masa disiplinore, nga të cilat janë marrë masat: "Lirim nga Detyra" për 2 (dy) punonjës, Ish Regjistruesi dhe Ish Përgjegjësi i Sektorit të Regjistrimit dhe Hartografisë dhe nuk ka shkresë nga Kryeregjistruesi për 12 masa të tjera disiplinore.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme:

MASE PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Rekomandimi i lënë:

Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës 175.000 lekë sipas pasqyrës tarifa për kartelat e pasurisë së paluajtshme dhe regjistrim pasurie të paarkëtuar për periudhën 2013-2015.

Brenda muajit Mars 2017

2 Rekomandimi i lënë:

Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi:

- në shumën 300,000 lekë, nga Y.S.;
- në shumën 96,450 lekë, nga A.M., F.S., J.S., E.S. dhe V.S.;
- në shumën 300,000 lekë, nga T.H.;
- në shumën 300,000 lekë, nga T.C.;
- në shumën 3,500 lekë, nga A.M.;
- në shumën 300,000 lekë, nga B.N.

Brenda muajit Mars 2017

3 - Rekomandimi i lënë:

Regjistruesi i ZVRPP Berat të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerave të mëposhtme:

- Për shoqërinë “P” shpk, në vlerën prej 165,810 lekë;
- Për shoqërinë “F” shpk, në vlerën prej 422,700 lekë.

Brenda muajit Mars 2017

C. MASAT DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58, germa a, b, c, ç, “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 8, të kontratave individuale të punës ti rikërkojmë Kryeregjistruesit ZQRPP Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë dhe marrjen e masave disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” për 8 punonjës dhe “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për katër punonjës, pasi për këta punonjës nuk ka shkresë për dhënie masash disiplinor.

Brenda muajit Mars 2017

Për Verifikimin e zgjidhjen e Ankesave të Qytetarëve drejtuar KLSH-së,

Ti rikërkoj ZVRPP Berat trajtimin, zgjidhjen dhe kthimin e përgjigjes në KLSH, lidhur me ankesat e patrajuara si më poshtë:

3. Ankesa e qytetarit A.G., dërguar me shkresën nr. 423 Prot, datë 06.04.2016 nga KLSH, i cili ankohet për mosgjetje të dokumentacionit.

ZVRPP Berat i ka kthyer përgjigje qytetarit me 2767 Prot, datë 12.08.2016, pa i dhënë rrugëzgjidhje, duke e adresuar saktësisht drejtë zgjidhjes, dhe nuk i ka dërguar një përgjigje KLSH-së.

5. Ankesa e Bashkisë Berat lidhet me kërkesën e z. K.L. për ndërtimet e bëra nga Bashkia Berat në sheshin Qendror, dërguar nga KLSH me nr. 809/1 Prot, datë 08.08.2016.

Bashkia Berat është në proces gjyqësor pranë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Berat me palë të paditura, K.L., ATP Tiranë dhe ZVRPP Berat, por që ZVRPP Berat nuk rezulton ti ketë kthyer përgjigje KLSH-së.

Brenda muajit Mars 2017

17. ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ZVRPP) KUÇOVË”.

Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse janë lënë 26 rekomandime gjithsej, nga këto: 23 masa organizative dhe 3 masë zhdëmtimi me vlerën 595,860 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 23 masa organizative, të cilat, janë pranuar dhe janë realizuar plotësisht 23.

Masa për shpërblim dëmi janë lënë 3 rekomandime për shumën 595,860 lekë lekë të arkëtueshëm të cilat, *janë pranuar dhe pjesërisht janë zbatuar, pasi duhet të vazhdojë rruga ligjore për arkëtimin e vlerës.*

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **Ju rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme:

1. Rekomandimi i lënë:

Regjistruesi i ZVRPP Kucove, te marre masa, qe ne baze te pikes 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, te ligjit nr. 33, date 29.04.2012 “Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme”, bazuar ne shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdher kufizimi, per pasurine nr. 7/168 a-2 vol 13, faqe 6 dhe të kerkohet në rrugë ligjore nga investitori i objektit I.LI, arketimi i shumes **230,160 lekë** (Trajtuar hollesisht ne faqet 58-140, Raportit Perfundimtar te Auditimit).

Brenda muajit Mars 2017

2. Rekomandimi i lënë:

Regjistruesi i ZVRPP Kucove, te marre masa, qe ne baze te pikes 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, te ligjit nr. 33, date 29.04.2012 “Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme”, bazuar ne shkeljet e konstatuara te nxjerre urdher kufizimi per pasurin nr. 4/162 ne volumin 29 faqe 109 dhe te kerkohet ne rruge ligjore arketimi i shumes 300.000 leke, nga poseduesit e pasurise.

Brenda muajit Mars 2017

3. Rekomandimi i lënë:

Regjistruesi i ZVRPP Kucove, te marre masa, qe ne baze te pikes 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, te ligjit nr. 33, date 29.04.2012 “Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme”, bazuar ne shkeljet e konstatuara te nxjerre urdher kufizimi per pasurine nr. 3/4 ne vol. 29 faqe. 18 dhe te kerkohet ne rruge ligjore arketimi i shumes 65,700 leke nga poseduesit e pasurise.

Brenda muajit Mars 2017

C. MASAT DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58, germa a, b, c, ç, “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 8, të kontratave individuale të punës **ti kërkojmë Kryeregjistruesit ZQRPP Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga puna**” dhe për ata me kontratë, nga masa “**Vërejtje**” deri në “**Ndërprerje të marrëdhënieve të punës**”, për këta punonjës:

Nga Kryeregjistruesi ZQRPP Tiranë nuk ka shkresë për dhënie masash disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” për 1 punonjës dhe “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për 1 punonjës.

Brenda muajit Mars 2017

18. DREJTORIA RAJONALE E INSPEKTORATIT TË MJEDISIT DHE PYJEVE (DRISHMP) DURRËS.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 26 rekomandime gjithsej, nga këto: 24 masa organizative dhe 2 masë zhdëmtimi me vlerën 997,256 lekë,

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 24 masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 24, janë realizuar plotësisht 12 masa dhe janë në proces zbatimi 12 nga të cilat 9 në proces dhe 3 të pranuar nuk kanë filluar.

Për shpërblim dëmi janë lënë 2 rekomandime për shumën vlerën 997,256 lekë, të arkëtueshëm, janë pranuar, është realizuar pjesërisht detyrimi 884,400 lekë, likuiduar 90,200 lekë, mbetur 794,200 lekë ; ndërsa 1 masë e pranuar por e pa zbatuar për dëmin ekonomik prej 112,856 lekë,

c.1.Masa disiplinore, administrative për Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” përkatësisht

1-Z. J.D. me detyrë Kryeinspektor i DR ISHMP Durrës,

2. z E.K. me detyrë Jurist pranë DR ISHMP Durrës

3. znj. K.Z., me detyrë specialiste finance pranë DR ISHMP

nuk janë përfshirë për ekzekutim në shkresën nr. 799, dt. 07.07.2016, për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, programin e punës nr.798, datë 07.07.2016 për zbatimin e rekomandimeve si dhe Urdhrin e brendshëm nr.8, datë 07.07.2016.

C2. Masa disiplinore “Vërejtje” për 9 persona inspektor dhe përgjegjës sektori mjedisi rezulton e realizuar si vijon: Kjo masë disiplinore është e zbatuar për 3 persona dhe në proces për 6 persona ndërsa për 9 persona inspektore të pyjeve rezulton e realizuar si vijon: Kjo masë disiplinore është e zbatuar për 2 persona dhe në proces për 4 persona dhe nuk është zbatuar për 3 persona transferuar te Ujërat.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **Ju rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi i lënë:

13.-Nga N/A dhe Titullari i institucionit (aktualisht në DRISHMP Durrës Nëpunësi Autorizues është dhe Titullar institucioni), të ndiqen hapat e duhur ligjorë për instalimin dhe vendosjen e Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) dhe të hartohen e miratohen rregullat për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të shpenzimeve, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave në zbatim të Ligjit.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi i lënë:

15. Në DR ISHMP Durrës, Titullari i institucionit çdo fillim viti, të ngrejë një komision për testimin e konsumit të karburantit nga mjetet e transportit dhe të paraqitet një raport, duke përshkruar në rrugë konkrete normativën e konsumit të karburantit për çdo kategori mjet udhëtimi.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi i lënë:

16- DR ISHMP Durrës, sektori përkatës që mbulon burimet njerëzore, të marrë masa dhe të plotësojë dosjet e personelit me të gjitha të dhënat, konform kërkesave ligjore, si dhe çdo dosje të ketë inventarin e dokumentacionit të konfirmuar nga palët.

Brenda muajit Mars 2017

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Rekomandimi i lënë:

2. DR ISHMP Durrës të marrë masa të kontabilizojë dhe të ndjekë të gjitha hapat e duhur ligjore për arkëtimin e shumës së dëmit ekonomik prej 112,856 lekë, si rezultat i përfitimit padrejhtësisht nga punonjësi F.M., të “Vlerës së Pagës së Grupit”, të përcaktuar në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve” (Trajtuar hollësisht në faqet 35-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Brenda muajit Mars 2017

C. MASA DISIPLINORE

Rekomandim. Nga Inspektori i ISHMP Tiranë të nisin procedurat për marrjen e masave disiplinore, administrative ”Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” për tre punonjës dhe “Vërejtje” për 6 punonjës të DR ISHMP Durrës

19. DREJTORINË RAJONALE TË AGJENCISË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE TË NDËRTIMEVE INFORMALE (ALUIZNI) Berat”

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 22 rekomandime gjithsej, nga këto: 17 masa organizative dhe 5 masë zhdëmtimi me vlerën 1,711,218 lekë, si dhe nga auditimi i meparshëm 1 masë zhëmtuese përmbledhëse në vlerën 1,248,318 lekë. Gjithsej 6 masa zhdëmtuese me vlerën totale 2, 959,536 lekë.

-Për masën zhdëmtuese përmbledhëse me vlerën 1,248,318 lekë nga auditimi i meparshëm, konstatohet se janë në proces pasi janë arketuar 112,284 lekë ndaj K P 39,000 lekë dhe ndaj S Q 73,284 lekë

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

g. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 17 masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 17, janë realizuar plotësisht 4 masa dhe janë në proces zbatimi 13 nga të cilat 8 në proces dhe 5 të pranuar nuk kanë filluar..

h. Për shpërblim dëmi janë lënë 5 rekomandime për shumën 1,711,218 lekë të arkëtueshëm, të cilat, janë pranuar, është realizuar 1 me 450 mijë lekë dhe janë në proces zbatimi 4 rekomandime në vlerën 1,261,218 lekë.

c. Për 13 masa disiplinore nga të cilat 9 “Vërejtje me paralajmërim”, 1 masë “Zgjidhje kontratës së punës “ 3 masa “Ienie në kompetencë të Titullarit”, ndaj 13 punonjësve kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI Tiranë, nuk rezultojnë të jenë dërguar nga kjo Drejtori në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Berat.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **Ju rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi i lënë:

5. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat të marrë masa, për të gjitha objektet informale që nuk plotësojnë kriteret për legalizim, të ndiqen procedurat ligjore për s`kualifikimin e tyre si dhe të informohen në kohë aplikuesit e legalizimeve dhe institucionet bashkëpunuese.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi i lënë:

7. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat të marrë masa për saktësimin e pronës të objekteve të legalizuara dhe plotësimin me dokumentacionin e nevojshëm ligjor për regjistrimin në ZVRPP Berat, Kuçove, Ura Vajgurore, Kozarë dhe Skrapar dhe në rast mos plotësimi të kërkesave ligjore të zbatohen procedurat për s`kualifikimin e tyre.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi i lënë:

8. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat të marrë masa për plotësimin dhe hedhjen e të dhënave në database-n elektronik sipas procedurave ligjore dhe udhëzimeve përkatëse të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi i lënë:

10. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat, të marrë masa dhe të zbatojë legjislacionin në fuqi lidhur me legalizimin e objekteve informale dhe të mos lëshojë leje legalizimi në sipërfaqet e parcelave ndërtimore të llojeve “Kullotë” dhe “Pyll”, pa miratimin e Ministrisë së Mjedisit apo Vendim të Këshillit të Ministrave.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi i lënë:

15. Drejtoria e ALUIZNI-t Berat të marrë masat organizative për ndjekjen në rrugë ligjore deri në procese gjyqësore të arkëtimit të shpërblimit të dëmit në vlerën **17,958,848 lekë**.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi i lënë:

16. Drejtoria e ALUIZNI-t Berat të marrë masat organizative për ndjekjen në rrugë ligjore deri në procese gjyqësore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit në vlerën **15,809,883 lekë**.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi i lënë:

17. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat të marrë masat e nevojshme dhe të ndiqen procedurat ligjore për 82 (tetëdhjetedy) praktika legalizimi të ndërtimeve informale, të cilat nuk janë në përputhje me ligjin për integritetin e Monumenteve të Kulturës të zonave arkeologjike dhe nuk janë në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Berat.

Brenda muajit Mars 2017

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Rekomandimi i lënë:

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 për “Legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje ”, i ndryshuar, nga ana e titullarit të njësisë publike (*Nëpunësit autorizues*), të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohen në rrugë ligjore (*Padi Gjyqësore*), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në **25 raste në vlerën 1,248,318 lekë**.

Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin, të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël dhe kërkojë arkëtimin e vlerave deri në përfundim të detyrimeve *si më poshtë:*

Rekomandimi i lënë:

1. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-Berat, në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore të Qarkut Berat, të marrin masa duke ndjekur rrugët ligjore për llogaritjen, saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së taksës së infrastrukturës, si dhe dokumentacionin për tarifën e shërbimit, në **2 raste me vlerë 56,540 lekë**, prej të cilave dosja 2864, subjekti informal “F R M” **48,540 lekë** dhe dosja 454 “A S Sh” **8,000 lekë**.

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi i lënë:

3. Mbështetur në pjesën VI, kreu I, nenet 105-109, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (*Nëpunësit Autorizues*), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (*Padi gjyqësore*), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, me qëllim arkëtimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **345,110 lekë** nga ish drejtori K.P..

Brenda muajit Mars 2017

Rekomandimi i lënë:

5. Drejtoria e ALUIZNI-t Berat, të marrë masa duke ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **462,900 lekë** nga 3 qytetarët I. B., N. & Y. L. dhe Xh. Z., për zbatim të gabuar të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 3, datë 17/01/2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014”.

Brenda muajit Mars 2017

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58, germa a, b, c, ç, “*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në

komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 8, të kontratave individuale të punës, t’i rikërkojmë Drejtorit Përgjithshëm ALUIZNI Qendror Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për 13 punonjës, nga të cilët 9 “Vërejtje me paralajmërim”, 1 masë “Zgjidhje kontratës së punës“ 3 masa “Lënie në kompetencë të Titullarit”.

Për sa më sipër hartohet ky raport përfundimtar auditimi.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Bujar LESKAJ

KRYETAR